



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации



CENTER FOR ACTIVE CITIZENS
ЦЕНТАР ЗА АКТИВНИ ГРАЃАНИ



Hubumtim
I PASOJAVE NGA

RRITJA E SHPENZIMEVE

BUXHETORE TË

KOMUNAVE


NGA KRIZA NË VITIN 2022

NË FUSHAT TË CILAT

NDIKOJNË NË JETËN E

QYTETARËVE

kWh



Projekti:

Efektet e krizës financiare dhe energjetike mbi politikat dhe qytetarët

Hulumtim
I PASOJAVE NGA

RRITJA E SHPENZIMEVE

BUXHETORE TË

KOMUNAVE


NGA KRIZA NË VITIN 2022

NË FUSHAT TË CILAT

NDIKOJNË NË JETËN E

QYTETARËVE

kWh



shtator 2023

“Hulumtim i pasojave nga rritja e shpenzimeve
buxhetore të komunave nga kriza në vitin 2022 mbi
fushat të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve”

Botues: Qendra për Komunikime Qytetare

Autorë: Aleksandar Janev dhe German Filkov

Ekipi hulumtues: Pavlinka Strezoska dhe Elmir Fakiq

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:
Agon Ismaili

Dizajn grafik: Koma

Printoi: Koma

Tirazhi: 200

Tirazhi falas/jokomercial

CIP



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



CIVICA
MOBILITAS

| *Citizens for change!*

Projekti mbështetet nga Qeveria e Zvicrës përmes Civica Mobilitas. Mendimet e shprehura këtu nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë zvicerane, të Civica Mobilitas apo të organizatave që e zbatojnë atë.

PËRMBAJTJA

GJETJET KRYESORE	<u>4</u>
KONTEKSTI	<u>6</u>
HULUMTIM I DETAJUAR NË PASOJAT E RITJES SË SHPENZIMEVE BUXHETORE TË KOMUNAVE NGA KRIZA NË VITIN 2022 MBI FUSHAT TË CILAT NDIKOJNË NË JETËN E QYTETARËVE	<u>8</u>
Projektet kapitale të cilat kanë “pësuar”	<u>8</u>
Shpenzimet për energji, sa vlera e investimeve në objekte ndërtimore	<u>12</u>
Komunat me shkallën më të ulët të realizimit të zërit buxhetor 482 – Objekte tjera ndërtimore	<u>15</u>
Transferet nga niveli qendror në nivel lokal janë në rritje	<u>25</u>
Me ndryshime ligjore për të ardhura më të mëdha për komunat	<u>27</u>
REKOMANDIME	<u>31</u>
SHTOJCA	<u>31</u>
MATERIALET DHE BURIMET E TË DHËNAVE QË JANË PËRDORUR	<u>33</u>

GJETJET KRYESORE

- **Projektet kapitale, në vitin e krizës energjetike, i mbijetuan rebalansëve buxhetore, por në fund nuk u realizuan plotësisht.** Të gjitha NjVL-të së bashku, duke përfshirë Qytetin e Shkupit, në kulmin e krizës energjetike në vitin 2022, me rebalansime të ndara, konsiderueshëm i pakësuan planet për investime në objekte ndërtimore (zërat 481 dhe 482), nga 8,6 miliardë denarë (140 milionë euro) në 8,2 miliardë denarë (133 milionë euro). Megjithatë, ato kanë dështuar ndjeshëm kur është fjala për realizimin. Kështu, në fund, nga shuma fillimisht e planifikuar janë investuar 5,5 miliardë denarë (89 milionë euro), që donë të thotë se nuk janë realizuar projekte kapitale ndërtimore me vlerë të përgjithshme prej 3 miliardë denarë (51 milionë euro).
- **Shpenzimet për energji sa vlera e investimeve në objektet e ndërtimit.** Me rebalanset, të gjitha NjVL-të i zmadhuan zërat buxhetorë nga të cilët paguhej energjia, përkatësisht 421 - Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport dhe 461 - Subvencione për ndërmarrjet publike, edhe atë nga 3,4 miliardë denarë (56 milionë euro) në 5,3 miliardë denarë (86 milionë euro). Realizimi i këtyre dy zërave në fund të vitit 2022 arrin deri 4,7 miliardë denarë (76 milionë euro). Rezulton që zmadhimi i shpenzimeve për energji është tërësisht e mbuluar me komoditetin financiar të krijuar nga mosrealizimi i investimeve kapitale në vitin 2022.
- **Në vitin 2022, të gjitha NjVL-të kanë shpenzuar rreth 74,6% më shumë para nga zëri buxhetor 421 - Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, në krahasim me vitin 2021.** Megjithëse autoritetet kanë ndërmarrë një sërë masash për kursim të energjisë në institucionet shtetërore, rritja e shpenzimeve për energji të komunave në nivel vjetor është shumë më e lartë se shkalla e regjistruar e inflacionit në kategorinë Energji elektrike, gaz dhe derivate, ku çmimet mesatare në vitin 2022 janë zmadhuar për 16% në krahasim me vitin 2021.
- **Madje 19 NjVL kanë shkallë të mosrealizimit shumë më poshtë nga mesatarja e realizimit të objekteve të ndërtimore kapitale.** Kjo donë të thotë që në nivel komunash, devijimi mes asaj që është planifikuar dhe që është realizuar është nga 570 mijë deri në 12 milionë euro. Vetëm ky grup i NjVL-ve është "fajtor" për mosrealizimin e 84% të të gjitha objekteve kapitale të pandërtuara vitin e kaluar. Në shtojcë të hulumtimit është paraqitur listë e të gjitha këtyre komunave dhe projekteve konkrete kapitale që janë planifikuar por nuk janë ndërtuar në vitin 2022, nën ndikimin e krizës energjetike.
- **Në 70 NjVL shpenzimet kapitale janë më të ulëta se 100 euro për kokë banori në nivel vjetor.** Në këto komuna jeton 95% e popullsisë së vendit, ndërsa në 11 komunat tjera jeton vetëm 5% e popullsisë me shpenzime kapitale më të larta se 100 euro për banor në nivel vjetor.
- **Te shpenzimet e tjera, autoritetet lokale kanë vepruar sikur të mos ketë qenë krizë,** pra në vitin 2022, ka pasur rritje në shpenzimet për udhëtime dhe shpenzimet për mëditje (zëri buxhetor 420) edhe atë deri 145% në krahasim me vitin e mëparshëm, për pagat bazë (zëri buxhetor 401) shpenzimet janë zmadhuar për 5.4%, shërbimet kontraktuese (425) në vitin 2022 janë zmadhuar për 25.9% në nivel vjetor, ndërsa shpenzimet për punësime të përkohshme (427) janë zmadhuar për 3.3%.
- **Dallime të mëdha vërehen në shpenzimet buxhetore të komunave, për kokë banori. Buxhetin më të madh**

për kokë banori e ka Novaci, 736 euro, ndërsa në vendin e fundit është Pllasnica, buxheti i së cilës për kokë banori është gjashtë herë më i vogël edhe atë në shumë prej vetëm 117 euro.

- Edhe përkrah transfereve të zmadhuara për 10% nga buxheti qendror në vitin 2022, të cilat u mundësuan me ndryshimet ligjore për decentralizim më të madh fiskal, të ardhurat totale të të gjitha NJVL-ve në nivel vjetor janë rritur vetëm për 0.9%. Kjo është kryesisht për shkak të inkasimit të dobët të tatimeve për shërbime specifike (Kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore, tarifatat komunale).
- Në të njëjtën kohë, komunat përsëri kanë akumuluar borxhe në shumë prej 4.084.138.029 denarë (66,4 milionë euro) detyrime të maturuara, në fund të vitit 2022, përkundër përpjekjes së shtetit në vitin 2019 për të shlyer një pjesë të madhe të detyrimeve të papaguara. Në fund të vitit 2022, madje 14 komuna kanë pasur llogari të bllokuara.



KONTEKSTI

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut po jetojnë në periudhën më të pasigurt dhe më të vështirë ekonomike në 20 vitet e fundit. Ajo që filloi si krizë shëndetësore, me pandeminë KOVID-19, për një kohë të shkurtë u shndërrua në krizë ekonomike dhe financiare, ndërsa vitin e kaluar, veçanërisht pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, vendi dhe qytetarët u përballën edhe me krizë energjetike.

Krizat ndikuan me uljen e të hyrave në buxhet për shkak të uljes së konsiderueshme të aktivitetit ekonomik, ndërkohë që u shtuan nevojat dhe u rritën çmimet për shumë produkte bazë. Krahas ndikimit negativ të krizave në financat publike, ato kishin një ndikim veçanërisht negativ te njerëzit, mbi standardin e tyre të jetesës, madje edhe në disa nga të drejtat e tyre themelore. Në veçanti janë prekur grupet e varfra dhe të marginalizuara, situata e të cilëve, edhe ashtu e vështirë,

vetëm se u thellua. E gjithë kjo ka ndikim edhe afatshkurtër edhe afatgjatë mbi qytetarët dhe jetën e tyre, drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi, si kushtet dhe mjedisi për jetë dhe punë.

Nga ana tjetër, krizat i dëmtuan demokracinë tashmë të brishtë si dhe shtetin e së drejtës, sepse kapacitetet e kufizuara të pushtetit qendror dhe pushtetit

lokal ishin të fokusuara kryesisht në përballimin me situata të jashtëzakonshme. Duke ndërmarrë masa kryesisht ad hoc për ballafaqimin me krizat, autoritetet e harruan përgjegjësinë, llogaridhënien, transparencën, madje edhe informimin e publikut për efektet e krizës dhe të masave mbi qytetarët, jetën dhe punën e tyre, si dhe mbi të drejtat e tyre.

Politikat dhe masat të cilat i ndërmarrin pushteti qendror dhe pushteti lokal si përgjigje ndaj krizës financiare dhe energjetike (e cila manifestohet në inflacion dyshifror, çmimet e larta të derivateve, rënie të vazhdueshme të standardit të jetesës së qytetarëve dhe stagnim të ekonomisë) pasqyrohen mbi buxhetet.

Organizatrat civile, si dhe qytetarët, nuk ishin mjaftueshëm aktivë në monitorimin e këtyre proceseve dhe rrjedhimisht, nuk janë identifikuar dobësitë konkrete të cilat lejojnë që interesi publik të jetë nën interesat politike dhe “blerjen e pages” afatshkurtër në lidhje me krizën ekonomike. Publiku informohet vetëm për aspektet e shpenzimeve buxhetore të cilat konsiderohen si relevante edhe nga bartësit e pushtetit qendror edhe nga bartësit e pushtetit lokal. Gjatë gjithë kësaj periudhe, jo vetëm që nuk u analizua dhe nuk u fol për problemin, por i njëjti madje u injorua me zhvillimet e reja politike në vend, të cilat, në një farë mënyre, i zhvendosën nga diskursi publik, çështjet thelbësore për të cilat projekti duhet të japë përgjigje. Domethënë, në vend që analizave, diskutimeve dhe aktiviteteve t’u shtohet çështja e ndikimit negativ nga krizat në jetën e njerëzve, temë dominuese ishte ndikimi i krizave në financat publike. Ndërkaq, narrativët si financat publike, huamarrjet, “vrimat” në buxhetet etj., vazhdojnë të jenë sikur diçka “e panjohur” dhe e largët për njerëzit kurse jo si diçka që lidhet drejtpërsëdrejti me qytetarët, jetën e tyre dhe (mos)realizimin e të drejtave të njeriut.

Së këtejmi, bëhet gjithnjë e më e nevojshme që të pikasen ato ndikime te njerëzit dhe të shërbejnë si një udhërrëfyes për veprim në rast të krizave të reja ose të vazhdimit të krizave aktuale. Prandaj, kjo analizë kishte për synim t’i detektojë fushat të cilat janë më së shumti të prekura nga kriza energjetike, përkatësisht ato fusha, në të cilat janë bërë shkurtime më të mëdha (të

Krizat ndikuan me uljen e të hyrave në buxhet për shkak të uljes së konsiderueshme të aktivitetit ekonomik, ndërkohë që u shtuan nevojat dhe u rritën çmimet për shumë produkte bazë.

shpenzimeve) buxhetore për të mundësuar të mbulohen shpenzimet (pagesat) e rritura si pasojë e krizës. Pra, të zbulohet se si shpenzimet buxhetore të shtetit dhe të komunave për vitin 2022, të cilat janë ndryshuar nën ndikimin e krizës ekonomike (inflacion, stagnim dhe krizë energjitike), reflektohen te qytetarët, nëpërmjet hartëzimit të segmenteve ku gjenden mangësitë më të mëdha dhe përmes propozimit të masave të cilat duhet të mundësojnë që shpenzimet të jenë në interesin më të mirë të qytetarëve.

Në mënyrë metodologjike, të dhënat e nevojshme për hulumtimin dhe analizën janë mbledhur nga burime parësore (drejtpërsëdrejti nga institucionet e përfshira, faqet e tyre të internetit, intervista, si dhe përmes kërkesave për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik) dhe nga burime dytësore (nga institucione tjera, ueb-faqe, institucione ndërkombëtare, etj.). Klasifikimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura është bërë duke përdorur programe dhe aplikacione kompjuterike në mënyrë që të dhënat të jenë të përshtatshme për analizë cilësore. Analiza është bërë në mënyrë sasiore, nëpërmjet përpunimit matematikor të të dhënave numerike, si dhe në mënyrë cilësore, përmes analizës përshkruese dhe kontekstuale të gjendjes, shkaqeve dhe pasojave. Në fokus të hulumtimit janë buxhetet e shtetit dhe të komunave në të cilat janë paraqitur politikat dhe shpenzimet që janë planifikuar (buxheti i miratuar), ndikimi i krizës mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe si rrjedhojë, ndryshimet dhe amendimet në buxhetet (rebalans i buxhetit si dhe vendimet për rishpërndarje të mjeteve), si dhe ngjarjet reale dhe shkalla e realizimit të politikave, por edhe një prezantim i tërthortë e efekteve në jetën e qytetarëve (nëpërmjet realizimit të buxhetit, përkatësisht, llogarisë përfundimtare të buxhetit).



HULUMTIM I DETAJUAR NË PASOJAT E RRIJES SË SHPENZIMEVE BUXHETORE TË KOMUNAVE NGA KRIZA NË VITIN 2022 NË FUSHAT TË CILAT NDIKOJNË NË JETËN E QYTETARËVE


Shumë rrugë shtetërore dhe rrugë urbane, bulevarde, trotuare, sheshe, infrastruktura komunale, kopshte për fëmijë dhe shkolla, gazifikime të komunave - mbetën të porealizuara në vitin 2022, sepse pushtetet lokale, me buxhetet e reviduara i kanë shkurtuar mjetet për këto projekte nga planet e tyre për investime kapitale, për shpenzime më të larta për energji në vazhden e krizës energjetike dhe ekonomike.

Edhe projektet që arritën t'u "mbijetonin" rebalansëve, nuk u realizuan plotësisht sepse kanë mbetur vetëm të shkruara në buxhetet e reviduara.

Gjatë kësaj krize të madhe energjetike, kur çmimet e energjisë, por edhe të çdo produkti tjetër, u rritën deri në tavan, duke arritur shkallë të inflacionit vjetor prej pothuaj 20% në tetor të vitit të kaluar, komunat me rebalanset, në realitet i zmadhuan planet e tyre për shpenzime, mirëpo për nevojat rrjedhëse.

Buxhetet fillestare të komunave në vitin 2022 ishin 45.050.433.609 denarë (732.527.375 euro). Me rebalansin e buxheteve kjo shumë madje është zmadhuar për 5,24%, përkatësisht për 2.361.703.989 denarë (38.401.691 euro). Me këtë, buxheti i përgjithshëm i të gjitha NjVL-ve arriti shumë 47.412.137.598 denarë (770.929.066 euro), por në fund të vitit janë realizuar 83,73% nga kjo shumë, përkatësisht 39.697.534.979 denarë (645.488.374 euro).

Vlera e buxheteve totale komunale dhe realizimi i tyre në vitin 2022 (në milion euro)



Shpenzimet buxhetore të realizuara për çdo Njësi të Vetëqeverisjes Lokale veçmas, lëvizin nga 94 milionë euro në Qytetin e Shkupit e deri në 492 mijë euro në Pllasnicë. Për kokë banori, komuna Novaci ka buxhetin më të madh, 736 euro, ndërsa në pozitën e fundit është Pllasnica, buxheti i së cilës për kokë banori është gjashtë herë më i vogël dhe arrin shumë prej vetëm 117 euro. Një prezantim i detajuar i buxheteve të realizuara të NjVL-ve është paraqitur në shtojcë të këtij hulumtimi.

Projektet kapitale të cilat kanë "pësuar"

Secila nga 81 Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, vitin e kaluar ka shpenzuar 6.477.414.780 denarë (105.323.817 euro) për projekte kapitale, që donë të thotë se kanë realizuar 63.2% të shumës fillimisht të planifikuar në zërin buxhetor 48 - Shpenzime kapitale. Megjithatë, ky zë buxhetor, përveç që i përfshin objektet ndërtimore të cilat konsiderohen si investime kapitale në publik, i njëjti është më i gjerë dhe përfshin edhe blerje të pajisjeve dhe makinerive, mobiljeve, mjeteve motorike, përkatësisht mallra të tjera kapitale të cilat nuk konsiderohen si investime produktive, siç janë objektet ndërtimore, përkatësisht rrugët lokale dhe urbane, trotuaret, kopshtet për fëmijë, infrastruktura komunale dhe infrastrukturat tjera publike.

Në kohë krize, pozicioni buxhetor 480 - Blerje e makinerive dhe pajisjeve është realizuar më pak se në vitin 2021, edhe atë për 15.9% kurse më pak është shpenzuar edhe për blerje të mobiljeve dhe mjeteve motorike.

Shpenzimet kapitale të NjVL-ve në vitin 2022, në denarë

Zëri buxhetor	Buxhetet fillestare	Rebalansimi i buxheteve	Realizimi
48-Shpenzime kapitale	10,253,679,825	9,865,717,403	6,477,414,780
480-Blerje e pajisjeve dhe makinerive	779,642,271	802,359,573	478,390,521
481-Objekte ndërtimore	539,539,601	492,531,893	251,646,687
482-Objekte tjera ndërtimore	8,043,958,257	7,706,750,996	5,202,627,818
483-Blerje e mobiljeve	105,411,858	90,372,968	42,891,412
484-Mallrat strategjike dhe rezervat e tjera	151,660	151,660	30,150
485-Investime dhe mjete jofinanciare	465,075,476	417,760,066	258,668,890
486-Blerje e mjeteve motorike	279,394,702	311,131,711	199,156,774
489-Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare	40,506,000	44,658,536	44,002,528


Më konkretisht, për projektet e ndërtimit infrastrukturor, analiza e zërave të caktuar buxhetorë që konsiderohen si investime kapitale e që drejtpërsëdrejti mund të përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve, përkatësisht zëri buxhetor 481 - Objekte ndërtimore (ku bëjnë pjesë objektet e banimit dhe objektet afariste), tregojnë që me rebalansin në vitin 2022 është zvogëluar për 9%, ndërkaq, në anën tjetër, zëri buxhetor 482 - Objekte tjera ndërtimore (ku bëjnë pjesë rrugët urbane, rrugët shtetërore, urat, deponitë për hedhurina, mjetet për telekomunikime dhe për energji dhe objekte të tjera) është zvogëluar për 4%.

Në fakt, pikërisht te këto zëra të rëndësishëm ka ndodhur një nivel shumë i ulët i realizimit, përkatësisht në zërin 481 - Objekte ndërtimore, janë realizuar projekte në vlerë prej 251.646.687 denarë (4,1 milion euro), që është vetëm gjysma, përkatësisht 51 % e shumës së paraparë me rebalansin. Ndërkaq, krahasuar me buxhetin fillestar, realizimi është edhe më i ulët, përkatësisht vetëm 46.6%.

Një zë tjetër buxhetor më i madh, 482 - Objekte tjera ndërtimore, nga shuma fillimisht e planifikuar prej 8.043.958.257 denarë (130,8 milionë euro), me rebalansin

është zvogëluar në 7.706.750.996 denarë (125,3 milionë euro) ndërsa prej tyre, deri në fund të vitit 2022, janë realizuar 5.202.627.818 denarë (84,6 milionë euro), që paraqet 67% në raport me shumën e planifikuar me rebalansin, përkatësisht 65% nga plani fillestar në fillim të vitit 2022.

Zëri buxhetor 482 - Objekte tjera ndërtimore në vitin 2022 (në milion euro)



Gjithsej nga këta dy zëra buxhetorë, investimet në objekte ndërtimore në vitin 2022 janë në shumë prej 5454.274.505 denarë (88,7 milionë euro) dhe kjo paraqet vetëm 13,7% nga të gjitha shpenzimet e bëra nga ana e autoriteteve lokale atë vit.

Së këtejmi, rezultojnë se të gjitha NjVL-të së bashku, duke përfshirë Qytetin e Shkupit, nuk kanë realizuar projekte kapitale ndërtimore në vlerë totale prej 3.129.223.353 denarë (50,9 milionë euro) në raport me planin fillestar në fillim të vitit 2022.

Megjithatë investimet kapitale gjatë kohës kanë tendencë të mos realizohen tërësisht, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, viti 2022 është madje më i dobët në krahasim me realizimin e këtyre investimeve edhe në vitin 2021 edhe në vitin 2020.

Është e evidente që viti 2021 është një lloj viti "rekorder" sa i përket investimeve kapitale të realizuara, por është

një vit zgjedhor kur "punohet" me dinamikë më të fortë se zakonisht.

Nëse bëhet krahasim me vitin 2021, kur janë investuar 7.336.760.741 denarë (119,3 milionë euro), rezultojnë që në vitin 2022, kur ka qenë kriza, realizimi i investimeve nga zëri buxhetor 482 është zvogëluar për 2.134.132.923 denarë (34,7 milionë euro).

Veçanërisht zhgënjën krahasimi me vitin 2020 në vazhdim të pandemisë dhe aktivizimit të shpeshtë të orës policore, që ishte shkas për ngadalësimin e aktivitetit ndërtimor nga ana e shtetit. Rezultojnë që në vitin 2022, kryetarët e komunave kanë ndërtuar më pak infrastrukturë se sa gjatë pandemisë, në vitin 2020.

Përndryshe, vlera e investimeve kapitale vitin e kaluar, e shprehur në çmime rrjedhëse, është dukshëm e "fryrë" për shkak të inflacionit të lartë dyshifror, karakteristik vetëm për atë vit.

Shpenzimet kapitale të NjVL-ve, në denarë

Zëri buxhetor	2018	2019	2020	2021	2022
48 - Shpenzime kapitale	5,315,781,679	7,261,426,797	6.525.3714.746	8,788,398,720	6,477,414,780
480 - Blerje e pajisjeve dhe makinerive	246,166,793	355,078,650	380,295,620	568,846,632	478,390,521
481 - Objekte ndërtimore	522,194,359	762,037,783	188,863,000	241,779,200	251,646,687
482 - Objekte tjera ndërtimore	4,208,932,787	5,497,688,993	5,502,330,866	7,336,760,741	5,202,627,818
483 - Blerje e mobiljeve	42,123,950	63,185,078	37,547,447	53,877,123	42,891,412
484 - Mallrat dhe rezervat strategjike	166,488	0	82,065	33,007	30,150
485 - Investimet dhe aktivitetet jofinanciare	201,538,731	309,666,353	213,178,886	237,817,105	258,668,890
486 - Blerje e mjeteve motorike	62,871,246	189,443,321	120 617 923	258,147,913	199,156,774
489 - Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe OJQ-të	31,787,325	84,326,619	82,455,939	91,136,999	44,002,528

Niveli i ulët i investimeve kapitale më së miri reflektohet nga prezantimi i shpenzimeve kapitale të realizuara në vitin 2022, për kokë banori. Rezulton që madje 70 njësi të vetëqeverisjes lokale kanë shpenzime kapitale më të ulëta 100 euro për kokë banori në nivel vjetor. Në këto komuna jeton 95% e popullsisë së vendit, ndërsa vetëm 5% e popullsisë jeton në ato 11 komuna në të cilat shpenzimet kapitale janë mbi 100 euro për kokë banori në nivel vjetor.

Vlera e shpenzimeve kapitale konkrete për kokë banori lëviz nga 10 euro në Saraj deri në 269 euro në Karbinci.

Shpenzimet kapitale të NJVL-ve në vitin 2022, për kokë banori

Komuna	Në denarë	Në euro
Karbinci	16,521	269
Petrovec	15,085	245
Konçe	11,448	186
Novaci	11,116	181
Rosoman	9,249	150
Kavadari	8,835	144
Demir Kapi	8,594	140
Makedonska Kamenica	8,116	132
Debërca	7,145	116
Gradsko	6,964	113
Ilinden	6,623	108
Dojran	6,017	98
Shën Nikolle	5,852	95
Bogdanci	5,825	95
Sopishtë	5,689	93
Novo Sello	5,231	85
Rankovce	5,123	83
Berovë	5,112	83
Zelenikovë	4,918	80
Manastir	4,890	80
Strumicë	4,508	73
Bërvenicë	4,487	73

Qendër	4,397	72
Çuçer - Sandevë	4,137	67
Gazi Baba	4,126	67
Probishtip	4,056	66
Ohër	3,891	63
Staro Nagoriçane	3,823	62
Pehçevë	3,787	62
Vevçani	3,649	59
Maqedonski Brod	3,646	59
Kočani	3,598	59
Pllasnica	3,552	58
Zërnovci	3,480	57
Kriva Pallankë	3,373	55
Likovë	3,161	51
Radovish	3,077	50
Vasilevë	2,990	49
Kumanovë	2,964	48
Dellçevë	2,906	47
Çashkë	2,815	46
Llozovo	2,807	46
Shtip	2,798	46
Mogillë	2,782	45
Veles	2,746	45
Jegunovcë	2,602	42
Qendra Zhupë	2,595	42
Strugë	2,540	41
Mavrovë dhe Rostushë	2,409	39
Gjevgjeli	2,332	38
Krivogashtani	2,174	35
Negotinë	2,169	35
Aerodrom	2,151	35
Qyteti i Shkupit	2,127	35
Dibër	2,118	34
Goçe Petrov	2,110	34
Resnjë	2,075	34
Prilep	2,035	33
Vallandovë	1,986	32

Krushevë	1,607	26
Kërçovë	1,597	26
Tetovë	1,550	25
Gostivar	1,546	25
Vrapçishtë	1,499	24
Çeshinovë - Obleshevë	1,428	23
Vinicë	1,348	22
Demir Hisar	1,313	21
Tearcë	1,249	20
Kisella Voda	1,166	19
Dollneni	1,156	19
Çair	1,099	18
Butel	1,031	17
Bogovinje	1,031	17
Shuto Orizarë	659	11
Haraçinë	659	11
Saraj	611	10

Shpenzimet për energji, sa vlera e investimeve në objekte ndërtimore

Në të njëjtën kohë, me rebalansin e buxhetit total të të gjitha NjVL-ve, gjatë krizës energjetike, është bërë rritje e zërave buxhetorë 421 - Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport dhe 461 - subvencione për ndërmarrjet publike, të cilat janë në lidhje të drejtpërdrejtë me shpenzimet e zmadhuara të energjisë për shkak të rritjes së madhe të çmimeve të energjisë elektrike dhe të derivateve.

Zërat buxhetor 421 dhe 461 në vitin 2022, në denarë

Përshkrimi i zërit buxhetor	Buxhete fillestare	Rebalanse të buxheteve	Realizimi
421-Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	2,845,869,669	4,243,129,672	3,690,467,075
461-Subvencionet për ndërmarrjet publike	594,001,500	1,014,708,835	991,738,434

Zëri buxhetor 421 - Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, fillimisht ka qenë i projektuar me shumë 2.845.869.669 denarë (46.274.303 euro), e më pas me rebalansin, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, përgjithësisht të rritet në 4.242.129.129.129 denarë (68.977.718 euro), që paraqet rritje prej madje 1.396.260.037 denarë (22.703.415 euro) përkatësisht, për 49%.


Për zërin buxhetor 461 - Subvencionet për ndërmarrjet publike, fillimisht janë paraparë shpenzime në shumë prej 594.001.500 denarë (9,6 milionë euro), të cilat më pas janë zmadhuar për 70,8% në 1.014.708.835 denarë (16,5 milionë euro). Prej tyre janë realizuar 97,7% përkatësisht, 991.738.434 denarë (16,1 milionë euro). Megjithatë, këto shpenzime janë 19,7% më të larta se në vitin 2021.

Sipas të dhënave nga Thesari, përmes hulumtimit mbi të gjitha pagesat në platformën 'Financa të Hapura', nga zëri buxhetor 461, më së shumti mjeteve financiare në vitin 2022 ka transferuar Qyteti i Shkupit, edhe atë 810.261.867 denarë (13,2 milionë euro), që paraqet 81,8. % të të gjitha shpenzimeve në këtë pozicion buxhetor. Më së shumti mjete financiare i janë transferuar Ndërmarrjes për Qarkullim Publik (NQP) përmes programit J5, Transport Publik Lokal i Pasagjerëve.

Komuna e radhës me më së shumti subvencione për ndërmarrjet publike është Prilepi, me 86.050.800 denarë (1,4 milion euro) të paguara, prej të cilave kryesisht për NPK Komunalec përmes programit J7, Mirëmbajtje dhe shfrytëzimi i parqeve dhe i sipërfaqeve me gjelbërim.

Komuna e tretë me më së shumti subvencione nga zëri buxhetor 461 është Gazi Baba, me 26,174,877 denarë (425 mijë euro) të paguara, të gjitha për NPK Gazi Baba 2007, përmes programit J8, Shërbime tjera komunale.

Subvencionet të NjVL-ve për ndërmarrjet publike në vitin 2022



Fakti që në fund të fundit, shpenzimet e projektuara nuk u realizuan tërësisht, mund të jetë edhe për shkak të dimrit të butë, që mundësoi konsum më të vogël të energjisë elektrike dhe të derivateve tjera.

Realizimi i zërit buxhetor 421 – Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport është në shumën 3.690.467.075 denarë (60 milionë euro), që me rebalansin paraqet 87% të planit. Mirëpo, në krahasim me atë që ishte shpenzuar në vitin 2021, ky pozicion paraqet rritje për 74,6% përkatësisht, për 1.576.209.486 denarë (25.629.423 euro) më tepër.

Ndonëse autoritetet ndërmorën një sërë masash për kursim të energjisë në institucionet shtetërore, rritja e shpenzimeve komunale në nivel vjetor për energji ishte shumë më e lartë se shkalla e inflacionit të regjistruar në kategorinë Energji elektrike, gaz dhe derivate, ku çmimet mesatare në vitin 2022 u rritën për 16% krahasuar me vitin 2021.

Gjatë kësaj, është shumë e rëndësishme të kemi parasysh se të dhënat për shpenzimet janë marrë nga Propozim-Llogaria Përfundimtare e Buxhetit për vitin 2022, që donë të thotë se këtu janë përfshirë vetëm shpenzimet e paguara dhe nuk përjashtohet që realisht të jenë shpenzuar mjete me vlerë shumë më të madhe, por të njëjtat të mos jenë paguar dhe të jenë të regjistruara si borxhe të maturuara ose të pamaturuara.

Me përfundim të vitit 2022, detyrimet e përgjithshme të komunave arrijnë shumën prej 4.084.138.029 denarë (66,4 milionë euro) dhe në bazë vjetore bilanci ka shënuar rënie të vogël në shumën 4.251.965.991 denarë (69,1 milionë euro).

Është interesante që në vitin 2022, komunat kanë marrë përsipër dy herë më tepër detyrime që duhet të maturojnë në afat prej një viti. Pra, janë evidentuar detyrime të pamaturuara të komunave, të cilat duhet të maturojnë në afat prej një viti, në vlerë prej 872.072.131 denarë (14,2 milionë euro), shumë dyfish më e madhe se në vitin 2021.

Në total, dy zërat nga të cilët autoritetet lokale kanë paguar për energji (421 dhe 461) arrijnë vlerën prej 4.682.205.509 denarë (76,1 milionë euro), që paraqet 11,8% të të gjitha shpenzimeve që janë bërë në vitin 2022.

Mirëpo, shumën që e kanë paguar komunat për këtë dedikim në vazhden e krizës energjetike është sigurisht edhe më e lartë, po të merret parasysh që shumë NjVL, në situatën e paparashikuar dhe në kushte kur këta dy zëra buxhetorë janë shteruar financiarisht, kanë improvizuar duke kryer pagesa për energji nga zëri më i përgjithshëm buxhetor, 426 – Shpenzime tjera rrjedhëse. Nga ky zë buxhetor, vitin e kaluar janë paguar 458.227.066 denarë (7,5 milionë euro). Gjithashtu, në ndërmarrjet komunale lokale janë transferuar para edhe nga zëri më i përgjithshëm 464 - Transfere të ndryshme, i cili vitin e kaluar ka qenë me shumë 1.346.941.535 denarë (21,9 milionë euro).

Nga analiza e këtyre kategorive kryesore buxhetore rezulton që efektet negative nga zmadhimi i shpenzimeve për rrymë janë bërë në dëm të investimeve në objektet ndërtimore.

Megjithatë, te shpenzimet e tjera, autoritetet lokale kanë vepruar sikur të mos ketë qenë krizë, pra në vitin 2022, ka pasur rritje në shpenzimet për udhëtime dhe shpenzimet për mëditje (zëri buxhetor 420) edhe atë deri 145% në krahasim me vitin e mëparshëm, për pagat bazë (zëri buxhetor 401) shpenzimet janë zmadhuar për 5,4%, shërbimet kontraktuese (425) në vitin 2022 janë zmadhuar për 25,9% në nivel vjetor, ndërsa shpenzimet për punësime të përkohshme (427) janë zmadhuar për 3,3%.

Prezantim i shpenzimeve buxhetore të NJVL-ve për vitin 2022, në denarë

Përshkrimi i zërit buxhetor	Buxheti fillestar	Buxhet i rebalansuar	Realizimi 2022	Realizimi 2021
TOTAL	45,050,433,609	47,412,137,598	39,697,534,979	39,058,936,425
401-Pagat bazë	14,164,712,141	14,426,402,426	14,042,038,952	13,325,970,812
402-Kontribute për sigurim social	5,527,523,595	5,645,937,431	5,469,270,890	5,187,369,917
403-Kontribute tjera nga pagat	60,000	0	0	0
404 - Kompensime	415,580,970	433,093,978	388,674,551	333,905,813
411-Financim i programeve dhe nënprogrameve të reja	10,000	10,000	0	0
412-Rezervë e përhershme (shpenzime të paparapshikuara)	38,767,000	44,687,000	20,012,012	13,523,039
413-Rezerva korente (shpenzime të ndryshme)	60,635,000	56,755,000	25,497,276	34,206,944
420-Shpenzime për udhëtim dhe shpenzime ditore	399,414,542	459,426,537	227,906,146	93,160,237
421 - Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	2,845,869,669	4,243,129,672	3,690,467,075	2,114,257,589
423-Materiale dhe inventar i vogël	1,249,940,490	1,300,619,025	838,413,125	776,793,213
424 - Riparime dhe mirëmbajtje e vazhdueshme	2,805,635,552	2,867,505,116	2,153,175,538	2,589,576,647
425 - Shërbime me kontratë	2,692,244,587	2,783,485,448	1,990,921,940	1,581,711,625
426-Shpenzime të tjera rrjedhëse	699,540,545	687,894,173	458,227,066	429,195,279
427-Punësime të përkohshme	527,493,867	576,129,671	529,962,738	513,113,867
451-Pagesat e kamatave për kreditorët jorezidentë	5,960,000	5,221,082	1,907,648	3,413,064
452- Pagesat e kamatave për kreditorët vendas	56,666,424	46,954,556	35,073,296	33,565,444
453-Pagesat e kamatave për nivelet tjera të qeverisjes	100,000	100,000	41,755	32,566
461-Subvencionet për ndërmarrjet publike	594,001,500	1,014,708,835	991,738,434	828,243,182
462-Subvencione për ndërmarrjet private	0	0	0	0
463-Transfere për organizatat joqeveritare	411,285,712	459,776,775	406,438,269	316,186,302
464-Transfere të ndryshme	1,564,818,955	1,860,756,924	1,346,941,535	1,383,118,717
465-Pagesat sipas dokumenteve ekzekutive	231,760,000	134,674,036	133,256,762	125,804,790
471-Kompensime sociale	71,715,000	82,413,433	66,902,523	55,056,241
480-Blerje e pajisjeve dhe makinerive	779,642,271	802,359,573	478,390,521	568,846,632
481-Objekte ndërtimore	539,539,601	492,531,893	251,646,687	241,779,200
482-Objekte tjera ndërtimore	8,043,958,257	7,706,750,996	5,202,627,818	7,336,760,741
483-Blerje e mobiljeve	105,411,858	90,372,968	42,891,412	53,877,123
484-Mallrat strategjike dhe rezerva tjera	151,660	151,660	30,150	33,007
485-Investime dhe mjete jofinanciare	465,075,476	417,760,066	258,668,890	237,817,105
486-Blerje e mjeteve motorike	279,394,702	311,131,711	199,156,774	258,147,913
489-Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare	40,506,000	44,658,536	44,002,528	91,136,999
491-Shlyerja e kryegjësë nga kreditorët jorezidentë	144,984,976	141,673,100	134,729,255	161,197,336
492-Shlyerja e kryegjësë tek institucionet vendase	161,010,735	158,290,735	156,336,188	248,019,542
493-Shlyerja e kryegjësë në nivele të tjera të qeverisjes	127,022,524	116,775,242	112,187,225	123,115,539

Komunat me shkallën më të ulët të realizimit të zërit buxhetor 482 – Objekte tjera ndërtimore

Të 80 komunat dhe Qyteti i Shkupit, në vitin 2022 nuk kanë realizuar 2.841.339.261 denarë (46,2 milionë euro) fillimisht të planifikuara në zërin buxhetor 482 – Objekte tjera ndërtimore, ku bën pjesë ndërtimi i rrugëve urbane dhe lokale, trotuareve, urave, kopshteve fëminore, gazifikimi dhe të gjitha projektet tjera kapitale të infrastrukturës për të cilat mendohet se e përmirësojnë cilësinë e jetës

së qytetarëve në zonat lokale. Kjo donë të thotë që në nivel komunash, dallimi mes asaj që është planifikuar dhe asaj që është realizuar, lëviz prej shumës 570 mijë e deri në 12 milionë euro.

Megjithatë, deri 19 arrin numri i komunave të cilat nuk kanë realizim më të lartë edhe nga kjo vlerë mesatare.

Gjatë kësaj, 84% e mjeteve buxhetore të perealizuara në kategorinë 482 - Objekte tjera ndërtimore janë pikërisht nga këto 19 komuna, përkatësisht 2.396.299.660 denarë (38,9 milionë euro)

NjVL-të me dallimet më të mëdha ndërmjet mjeteve të planifikuara dhe të realizuara nga zëri buxhetor 482 – Objekte tjera ndërtimore në vitin 2022*

Komuna	Mjetet buxhetore fillimisht të planifikuara (denarë)	Realizimi (në denarë)	Dallimi (në denarë)	Dallimi (në euro)
Qyteti i Shkupit	1,688,772,000	944,684,701	744,087,299	12,098,980
Gorçe Petrov	288,540,228	83,263,690	205,276,538	3,337,830
Manastir	546,725,817	357,917,588	188,808,229	3,070,053
Kumanovë	363,638,041	179,953,200	183,684,841	2,986,745
Strumicë	346,832,330	184,264,486	162,567,844	2,643,380
Gazi Baba	435,698,000	273,854,505	161,843,495	2,631,602
Kisella Voda	152,476,024	50,855,507	101,620,517	1,652,366
Kërçovë	151,923,000	59,039,543	92,883,457	1,510,300
Prilep	134,462,000	55,878,227	78,583,773	1,277,785
Sopishtë	92,705,687	29,757,536	62,948,151	1,023,547
Qendër	163,343,600	90,866,400	72,477,200	1,178,491
Çair	118,417,925	58,649,604	59,768,321	971,843
Aerodrom	165,389,000	112,447,716	52,941,284	860,834
Radovish	100,271,156	57,819,299	42,451,857	690,274
Negotinë	73,454,613	33,836,236	39,618,377	644,201
Çuçer Sandevë	74,824,660	37,103,863	37,720,797	613,346
Tetovë	106,523,524	69,052,234	37,471,290	609,289
Koçani	136,310,000	100,222,370	36,087,630	586,791
Butel	67,890,000	32,431,240	35,458,760	576,565

*Sipas të dhënave për realizimin e buxheteve të NjVL-ve për periudhën 1.1. – 31.12.2022 nga Ministria e Financave

Njëkohësisht, në të 19 komunat, është shënuar rritje shumë e madhe e shpenzimeve nga zëri 421 – Shërbime komunale, ngruhje, komunikim dhe transport, edhe atë nga 30% në 120% në nivel vjetor. Përgjithësisht, këto 19 komuna, për këtë dedikim kanë shpenzuar 1.597.331.571 denarë (26 milionë euro), që donë të thotë se shuma e përgjithshme mund të jetë mbuluar me dy të tretat e objekteve kapitale të përealizuara nga zëri buxhetor - 482.

Me qëllim të identifikimit të objekteve konkrete ndërtimore të cilat kanë qenë të planifikuara ndërkaq nuk janë realizuar gjatë vitit 2022, janë dërguar kërkesa për qasje tek informacionet me karakter publik tek të gjitha 19 komunat e përmendura. Nga komunat është kërkuar të dorëzohen: listën e të gjitha objekteve dhe aktiviteteve të cilat kanë qenë të planifikuara, ndërsa nuk janë realizuar nga zëri buxhetor 482 - Objekte tjera ndërtimore nga buxheti i komunës për vitin 2022, me përshkrim të vendndodhjes dhe vlerës së planifikuar të objekteve dhe aktiviteteve individuale.

Procesi i mbledhjes së të dhënave ka zgjatur për thuhet 3 muaj, me ç'rast janë dorëzuar 18 ankesa, nga të cilat 9 janë për mos dërgimin të dhënave dhe 9 të tjera janë ankesa - kundër përgjigjes, për shkak të të dhënave jo të plota. Gjithashtu, në Agjencinë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik janë dorëzuar 5 kërkesa urgjente, për shkak të mosveprimit të komunave pas aktvendimit të pranuar nga Agjencia për t'i dërguar të dhënat e kërkuara.

Prej tyre, vetëm një komunë nuk është përgjigjur.

1. Qyteti i Shkupit

Qyteti i Shkupit është i pari në listën me shumën më të madhe të mjeteve të përealizuara për investime në objekte ndërtimore infrastrukturore në vitin 2022 gjatë krizës energjetike, në vlerë prej afër 12.1 milionë euro.

Lista e projekteve të përealizuara përfshin:

- ▶ Ndërtimi i rrugëve sipas kontratave të lidhura për rregullimin e tokës ndërtimore;
- ▶ Projektet për ndërtimtë të infrastrukturës komunale;
- ▶ Ndërtimi i sistemeve kryesore të furnizimit me ujë;
- ▶ Ndërtimi i sistemeve kryesore të kullimit;
- ▶ Ndrichi i shtegut në lumin Vardar;
- ▶ Instalimi i rrjetit për ndriçim publik në Komunën e Sarajit;
- ▶ Ndërtim i rrugës S9-rr. 1806 dhe rrugës S5-rr. 1688 dhe S2-rr. "Brigada e 2-të Maqedonase", Komuna Butel dhe Karposh;
- ▶ Ndërtimi i nyjes në Blvd. "Sllovenia" - kryqëzimi me Blvd. "Nikola Karev";
- ▶ Ndërtimi i rrugës ST1, pjesë të rrugëve S1, S2, S3 dhe S4 sipas PDU I12;
- ▶ Rehabilitim, mirëmbajtje e urave (ndërtim, karregjatë, trotuare, rrethoja, nyje zgjerimi dhe ndriçim);
- ▶ Ndërtimi i rr. "Boca Ivanova" nga rrethrotullimi deri në Blv. "H.T. Karposh";
- ▶ Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e shesheve të vogla, shesheve, rreshtave të pemëve, sipërfaqeve të gjelbra, rregullim i sipërfaqeve rreth objekteve të kulturës;
- ▶ Ndërtimi i Blvd. "Kroacia" – realizimi në faza;
- ▶ Ndërtimi i rr. "Ljubljanska" nga Blvd. "Ilinden" deri në Blv. "Sllovenia" (realizimi në faza);
- ▶ Hartim i projekti ndërkombëtar për parkun e parë të informatikës-inovacionit - INOPARK;
- ▶ Ndërtim, rehabilitim i Blvd. "Goce Dellçev";
- ▶ Rehabilitim i rr. "Rooseveltova" - realizimi në faza;
- ▶ Rehabilitim i "K. J. Pitu" dhe ndërtimi i rrethrotullimit në lumin kryqëzimin rrugor "K. J. Pitu" me "Koço Racin" dhe "K. J. Pitu" dhe rr. "Mirce Acev";
- ▶ Rrjeti i ujësjellësit përgjatë një pjese të rr. "Skupi", në pjesën e rrethrotullimit;

- ▶ Kanalizim atmosferik (kolektor) për rikahëzimin e ujërave atmosferike që gjenden në kolektor fekal, komuna Kisella Voda;
- ▶ Ndërtim i një pjese të kanalizimit fekal në komunën Shuto Orizarë dhe
- ▶ Ndërtim dhe rehabilitim i Kanalit Usjanski.

Në të njëjtën kohë, për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, Qyteti i Shkupit në vitin 2022 ka shpenzuar 570.066.582 denarë (9,3 milionë euro), që është më shumë se dyfishi, përkatësisht 117% më shumë se në vitin 2021, kur për të njëjtin dedikim janë shpenzuar 262.111.285 denarë (4,3 milionë euro).

Sa i përket zërit buxhetor tjetër, që po ashtu është zmadhuar në vitin 2022 nën ndikimin e krizës energjetike, përkatësisht zëri buxhetor 461 - Subvencione për ndërmarrjet publike, te Qyteti i Shkupit ka pasur shpenzime prej 810.261.867 denarë (13,2 milionë euro), që është për 21 % më tepër se 669.127.262 denarë (10,9 milionë euro) të cilat janë shpenzuar në vitin 2021.

2. Gorçe Petrov

Komuna Gjorçe Petrov është e vetmja nga 19 komunat që nuk ka dërguar përgjigje në kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, përkatësisht nuk e dorëzoi listën e projekteve që nuk janë realizuar nga zëri buxhetor 482 - Objekte tjera ndërtimore. Mirëpo, sipas Planit vjetor për prokurime publike të komunës, nuk janë shpallur konkurse për projektet e cekura më poshtë, që donë të thotë se ato kanë mbetur të porealizuara:

- ▶ Rindërtimi i një bashkësisë lokale në fshat. Orman;
- ▶ Blerje, transport dhe mbjellje e fidanëve (pemëve) pyjorë në shiritin e lumit Lepenec dhe fshatin. Novo Sello;
- ▶ Ndërtimi i zonave të reja të gjelbra dhe rregullimi hortikulturor si dhe mirëmbajtje nëpërmjet projektit për mjedis jetësor më të pastër;

- ▶ Ndërtimi dhe përfundimi i gardhit të oborrit dhe i hyrjes nga rruga në kopshtin e fshatit Vollkovë;
- ▶ Ndërtimi i rrugëve, shtigjeve, shesheve dhe hapësirave të tjera publike;
- ▶ Prokurim dhe vendosje e sinjalistikës së komunikacionit për rrugë sipas projektit të komunikacionit për lgj. Hrom dhe për nevojat e rrugëve tjera në komunë;
- ▶ Rikonstruksioni i terreneve sportive, sallave të shkollave - rikonstruksioni i dysHEMEVE në Komunën e GJORÇE PETROVIT;
- ▶ Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë dhe komplekse sportive në Komunën e GJORÇE PETROVIT;
- ▶ Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë në territorin e Komunës së GJORÇE PETROVIT;
- ▶ Ndërtimi i rrugëve në pjesën urbane të Komunës së GJORÇE PETROVIT;
- ▶ Punim dhe instalim i pajisjeve urbane;
- ▶ Rikonstruksioni dhe përshtatja e objektit të shkollës fillore në fshat. Kuçkovë.

Në total, sipas të dhënave nga Propozim- llogaria përfundimtare, kjo komunë, në vitin 2022 nuk ka realizuar mjete në vlerë prej 205.276.538 denarë (3.337.830 euro) nga zëri buxhetor - Objekte tjera ndërtimore.

Në të njëjtën periudhë, komuna ka shpenzuar 65.691.026 denarë (1.068.146 euro) për shërbime komunale, ngrohje, transport dhe komunikime, që është pothuaj dyfishi, përkatësisht 92,4% më tepër se në vitin 2021.

3. Manastir

Me pak mbi 3 milionë euro investime kapitale të porealizuara nga zëri 482 - Objekte tjera ndërtimore në vitin 2022, është Komuna e Manastirit.

Lista e investimeve të porealizuara përfshin 31 projekt:

- ▶ Kulmi i SHF "Gjorgji Sugarev";
- ▶ rruga "Mukos";

- ▶ NP Zhaben – zgjidhje e kanalizimit fekal;
- ▶ Dokumentacioni i projektit për Bashkësinë Lokale;
- ▶ Memoriali i Kullës së Sahatit;
- ▶ Mur mbajtës në lumin Dragor;
- ▶ Projektet bazë të trafikut sipas SS për ZQU;
- ▶ Blvd. "1 Maji" në Jeni Male;
- ▶ Rindërtim i konstruksionit të çatisë së SHF në fshat. Kishava;
- ▶ Gardh i parkut të gjelbër;
- ▶ Rregullim i sipërfaqeve të gjelbra me pajisje urbane dhe hortikulturë;
- ▶ Projekti bazë për rr. "Rruga industriale";
- ▶ Projekt urbanistik dhe projekt bazë për tokë ndërtimore;
- ▶ rruga "Gjorgji Dimitrov";
- ▶ Rehabilitim i një pjese të karregjatës për shkak të rrëshqitjes – Rehabilitim me ndërtim plotësues të rrugës lokale;
- ▶ Nyje septike dhe kullimi në SHF Cërnobuki;
- ▶ Lidhje për kanalizim të SHF fshati Kërklino;
- ▶ Gardh rreth shkollës në fshatin Llazhec;
- ▶ Sanimi i tualeteve në SHF në fshatin Kremenicë;
- ▶ Sanimi i fasadës dhe çati në sallën sportive "Boro Çurlevski";
- ▶ Adaptim i "Majçin Dom";
- ▶ Studim për konstatim të gjendjes së shtatë urave prej çeliku;
- ▶ Rindërtimi i shtëpisë malore Kopanki;
- ▶ Ndërtimi i rr. "Stuz" në ARM;
- ▶ Ndërtimi i një kompleksi multifunksional sportiv;
- ▶ Gazifikimi i Komunës Manastir;
- ▶ Ndërtimi i kopshtit për fëmijë në ARM;
- ▶ Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rr. "Stuz" në ARM;
- ▶ Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik në rr. "Stuz" dhe
- ▶ Ndërtimi i objektit të njësitit zjarrfikës të ARM-së.

Përndryshe, për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, Komuna e Manastirit në vitin 2022 ka shpenzuar 198.863.446 denarë (3.2 milionë euro), që është 117% më tepër se shumta prej 91.444.338 denarë (1.5 milionë euro) të shpenzuara në vitin 2021. Si subvencione për ndërmarrjet publike, në vitin 2022, kjo komunë ka transferuar 1.500.000 denarë, ndërsa një shpenzim i tillë nuk është regjistruar vitin e mëparshëm.

4. Kumanovë

Pothuaj 3 milionë euro është shumta të cilën e ka planifikuar Komuna e Kumanovës, por nuk e ka realizuar në vitin 2022, për ndërtim të objekteve tjera ndërtimore.

Ndër to janë projektet e mëposhtme:

- ▶ Ndërtimi i trotuareve në pjesë të tri rrugëve;
- ▶ Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën "Nikola Tesla";
- ▶ Ndërtimi dhe rikonstruksioni i ujërave të zeza atmosferike në rrugën "Bajram Shabani";
- ▶ Ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e infrastrukturës komunale (rrugë, kanalizime, ujësjellës, trotuare dhe shtylla) që do të realizohet varësisht nga mjetet e grumbulluara nga të ardhura të tjera të paplanifikuara (pjesëmarrje e qytetarëve, sponsorizime apo donacione të tjera);
- ▶ Ndërtimi i kanalizimit në rrugët "Blagoj I. Gune" dhe "Narodna revolucija";
- ▶ Rikonstruksion i objekteve, sallave sportive, rregullimi i katit përdhes dhe pishinës së qytetit (Salla e Sporteve Sokolana dhe pishina e mbyllur e qytetit);
- ▶ Rikonstruksioni i rrethojës ekzistuese dhe vendosje e rrethojës së re në rrugën "Tode Dumba";
- ▶ Rikonstruksioni i një sheshi të vogël pranë Shtëpisë së Kulturës dhe
- ▶ Ndërtim dhe rikonstruksion i 3 parkingjeve.

Sa i përket pjesëve tjera të prekura drejtpërdrejt nga kriza energjetike, për shërbime komunale, ngrohje,

komunikim dhe transport, kjo komunë në vitin 2022 ka shpenzuar 115.209.719 denarë (1,9 milionë euro), që paraqet 70,3% më tepër se shpenzimet për të njëjtin dedikim në shumë prej 67.646.384. denarë (1,1 milion euro) vitin e mëparshëm.

5. Strumicë

Komuna e Strumicës në vitin 2022 fillimisht kishte planifikuar të investojë 346.832.330 denarë (5,6 milionë euro) në objektet ndërtimore infrastrukturore nga zëri buxhetor 482. Megjithatë, deri në fund të vitit, të pa investuara kanë ngelur rreth 162.567.844 denarë (2,6 milionë euro).

Mirëpo, sipas përgjigjeve të komunës, nuk janë realizuar vetëm këto projekte në vijim:

- ▶ Realizim i trotuareve (7) dhe
- ▶ Asfaltim i një rruge.

Megjithatë, sipas të dhënave që ishin në dispozicion në Sistemit Elektronik për Prokurime Publike, Komuna e Strumicës ka planifikuar edhe ndërtimin e një parku të ri, rindërtimin e bulevardeve, rindërtimin e pjesëve të dëmtuara të sheshit, rehabilitimin e bulevardeve dhe betonimin e hapësirës rreth shatërvanëve në zonat e banuara. Të gjitha këto projekte mbetën pa realizim në vitin 2022.

Për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, kjo komunë në vitin 2022 ka shpenzuar 112.630.632 denarë (1,8 milion euro), që është dyfish, përkatësisht 105,7% më tepër se në vitin 2021.

6. Gazi Baba

Mbi 2,6 milionë euro të planifikuara për investime në 'Objekte tjera ndërtimore' (zëri 482) kanë ngelur të përealizuara edhe në buxhetin e komunës Gazi Babës.

Komuna ka dërguar një listë me 10 projekte që nuk janë realizuar nga ky zë buxhetor për vitin 2022, edhe atë:

- ▶ Ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe komunale;
- ▶ Ndërtimi i kanalizimit fekal;
- ▶ Ndërtimi i kanalizimit atmosferik dhe fekal;
- ▶ Projekti për rregullimin e kanaleve në pellgun e Karadakut të Shkupit;
- ▶ Zhvillimi i projekteve për objekte të tjera;
- ▶ Zhvillimi i projekteve të gazifikimit;
- ▶ Ndërtimi i një parkingu të montueshëm;
- ▶ Kryerje e mbikëqyrjes profesionale gjatë ndërtimit të kopshtit për fëmijë;
- ▶ Kopshti për fëmijë 'Qeramidnica' i
- ▶ Gazifikimi në territorin e Komunës Gazi Babë.

Për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, kjo komunë e Shkupit në vitin 2022 ka shpenzuar 111,025,313 denarë (1,8 milion euro), që është 60% më tepër se 69,692,061 denarë (1,1 milion euro) të shpenzuara nga i njëjti zë buxhetor në vitin 2021.

Për subvencione të ndërmarrjeve publike, nga kjo komunë në vitin 2022 kanë paguar 26.174.877 denarë (425.600 euro), që është shumë pothuaj e barabartë sikur edhe ajo në vitin paraprak.

7. Kisella Voda

Një komunë tjetër e Shkupit, në listën me dështimet më të mëdha në realizimin e zërit buxhetor 482 – Objekte tjera ndërtimore është komuna Kisella Voda, me 161.843.495 denarë të përealizuara (2,6 milionë euro).

Nga kjo komunë, përveç proekteve të përealizuara, i kanë paraqitur me numër edhe projektet e realizuara.

- ▶ Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve lokale dhe urbane; Të realizuara: 40, Të përealizuara: 24
- ▶ Ndërtimi i një hapësire për parkim; Të realizuara: 1, Të përealizuara: 1

- ▶ Ndërtimi i ndriçimit publik; Të realizuara: 2, Të porealizuara: 5
- ▶ Ndërtimi i sistemeve të furnizimit me ujë; Të realizuara: 6, Të porealizuara: 4
- ▶ Ndërtimi i sistemeve të kullimit dhe për trajtim të ujërave të zeza; Të realizuara: 11, Të porealizuara: 5
- ▶ Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe e natyrës; Të realizuara: 16, Të porealizuara: 0.

Sipas të dhënave për realizimin e shpenzimeve, kjo komunë në vitin 2022 ka shpenzuar 79.350.513 denarë (1,3 milion euro) për shërbime komunale, ngrohje dhe komunikim dhe transport, që është 60,8% më tepër se 49.331.032 denarë (802.1302 euro).

8. Kërçovë

Sipas përgjigjeve nga Komuna e Kërçovës, tri programe nuk kanë pasur implementim të plotë dhe atë:

- ▶ Shpenzimet kapitale të komunës (rindërtimi i objektit komunal) – janë planifikuar 15.300.000 denarë, janë realizuar 9.045.279 denarë;
- ▶ Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë (rindërtimi i sistemit të ujës-jellësit në fshatin Sërbicë dhe Novosellë) – janë planifikuar 9.000.000 denarë, janë realizuar 4.679.266 denarë. Sipas komunës, projekti ka përfunduar, ka mbetur vetëm pagesa;
- ▶ Shpenzimet kapitale për arsimin fillor (rindërtimi i sallës sportive Jançica) – janë planifikuar 2.000.000 denarë, janë realizuar 56.080 denarë.

Sipas Planit vjetor për prokurime publike të komunës së Kërçovës, gjatë vitit 2022, nuk janë shpallur konkurse dhe të porealizuara kanë mbetur projektet si në vijim:

- ▶ Rikonstruksioni i sallës sportive të Jançicës;
- ▶ Ndërtimi, rehabilitimi dhe sanimi i rrugëve lokale, rrugëve urbane, trotuareve dhe hapësirave tjera publike në Komunën e Kërçovës - me asfalt;
- ▶ Ndërtimi, rehabilitimi dhe sanimi i rrugëve lokale, rrugëve urbane, trotuareve dhe hapësirave tjera

publike në Komunën e Kërçovës - me elemente shtrimi (bekaton-tjegulla);

- ▶ Ndërtimi i 20 parqeve rekreative për fëmijë dhe
- ▶ Ndërtimi i një muri mbajtës në fshatin Kolari.

Vlera totale e planifikuar ndërsa e porealizuar e investimeve në 'Objekte tjera ndërtimore' të Komunës së Kërçovës për vitin 2022 është 92.883.457 denarë (1.510.300 euro).

Në përgjigjen nga komuna, megjithatë, kemi marrë informacione krejtësisht të ndryshme për shumën e porealizuar të investimeve nga zëri buxhetor 482, përkatësisht 27.343.457 denarë (445 mijë euro). Nga komuna pohojnë që i kanë realizuar të gjitha projektet e planifikuara, vetëm se nuk janë paguar në tërësi.

Nga zëri 421 – Shërbime komunale, ngrohje, transport dhe komunikacion, Komuna e Kërçovës vitin e kaluar ka shpenzuar 71.841.924 denarë (1.168.161 euro), që është 73% më tepër se në vitin 2021.

9. Prilep

Përgjigja nga Komuna e Prilepit, në vend të listës së projekteve konkrete që kanë mbetur të porealizuara në vitin 2022, përmban krahasim të asaj që është planifikuar dhe që është realizuar në 8 programe, prej nga, dukshëm shihet se dy nuk janë aspak të realizuara, ndërsa te pjesa tjetër, përqindja e realizimit lëviz nga 54% deri 98%.

- ▶ Projektet për efikasitet energjetik – 54% realizim,
- ▶ Vendosje e ndriçimit publik – 98% realizim,
- ▶ Ndërtimi i sistemeve për furnizim me ujë – 63% realizim,
- ▶ Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve lokale dhe rrugëve urbane – 89% realizim,
- ▶ Ndërtimi i sistemeve të kullimit dhe pastrimit të ujërave të zeza – 56% realizim,

- ▶ Shpenzimet kapitale për sport dhe rekreacion – 97% realizim.

Programet që nuk janë aspak të realizuara:

- ▶ JGA - Ndërtim i sistemeve për furnizim me ujë dhe
- ▶ JDA – Ndërtim dhe rehabilitim i rrugëve lokale dhe rrugëve urbane.

Për projekte konkrete, kemi shqyrtuar Planin vjetor për prokurime publike të komunës së Prilepit, në të cilin, pa shpallje për realizim kanë mbetur këto projekte:

- ▶ Ndërtimi i një pjese të sistemit lokal për furnizim me ujë – rrjeti i ujësjellësit dhe i objekteve hidroteknike në fshatin Kanatlarci;
- ▶ Renovimi i sallës sportive për ping-pong në rrethin e sallës sportive "Partizan";
- ▶ Rikonstruksioni i objekteve në energjetikë - rikonstruksioni i ndriçimit publik: Ndërrimi dhe instalimi i llambave ekzistuese me llamba ekonomike LED në qytet;
- ▶ Ndërtimi i sistemeve të kullimit dhe pastrimit të ujërave të zeza;
- ▶ Kanalizim atmosferik për: Segmente për kanalizime atmosferike në rrugë urbane të caktuara nëpër tërë qytetin;
- ▶ Ndërtimi i objekteve në sektorin e energjetikës – ndriçim publik në disa lokacione

Komuna e Prilepit nuk ka realizuar 78.583.773 denarë (1.277.785 euro), të planifikuara për ndërtim të Objekteve tjera ndërtimore.

Për shërbime komunale, ngrohje, transport dhe komunikime, komuna ka shpenzuar shumë më tepër se shuma e perealizuar e investimeve kapitale, përkatësisht 137.120.127 denarë (2.229.595 euro). Në nivel vjetor, këto shpenzime kanë qenë më të larta për 73%.

Gjithashtu, NjVL e Prilepit ka shpenzuar 86.873.017 denarë (1.412.569 euro) si subvencione për ndërmarrjet publike, pjesa më e madhe e të cilave ka përfunduar në mbulimin e shpenzimeve të zmadhuara për energji. Ky zë buxhetor është realizuar 26,8% më tepër në krahasim me vitin 2021.

10. Sopishtë

Nga komuna e Sopishtes gjithashtu, në vend të një liste me projekte konkrete të cilat nuk janë realizuar në vitin 2022, kemi marrë kundërpjetje për atë se çfarë konsiderohet projekt i realizuar, përkatësisht i perealizuar.

Nga aty thonë që disa projekte janë ndërtuar por se janë paguar në vitin 2023.

Në Planin për prokurime publike, i cili është ndryshuar disa herë gjatë vitit, kjo komunë nuk ka shpallur konkurse për projektet e përmendura më poshtë. Disa prej tyre u zhdukën nga Plani Vjetor më vonë gjatë vitit.

- ▶ Rindërtimi i rrugëve bujqësore në territorin e Komunës së Sopishtes;
- ▶ Rindërtimi i rrugëve urbane dhe rrugëve lokale;
- ▶ Asfaltimi i rrugës hyrëse deri te fusha e sportit në rr. 23.

Shuma e përgjithshme të cilën Komuna e Sopishtes e ka planifikuar ndërkaq nuk e ka realizuar për ndërtim të Objekteve tjera ndërtimore është 62.948.151 denarë (1.023.547 euro).

Nga komuna, kanë dhënë sqarimin se kryesisht bëhet fjalë për shpenzime prej donacioneve, të planifikuara me shumë prej 42,416,247 denarë (690 mijë euro), të cilat nuk janë siguruar nga burime qeveritare dhe ndërkombëtare, kështu që ato janë shkurtuar gjatë rebalansëve.

Ndërkaq, nga zëri buxhetor 421 janë shpenzuar 12.107.686 denarë (196.872 euro), përkatësisht 30,2% më tepër se në vitin 2021.

11. Qendër

Me 72.477.200 denarë të perealizuara (1,2 milionë euro), komuna Qendër është e radhës nga lista e komunave që kanë dorëzuar përgjigje për kërkesat për qasje tek informacionet me karakter publik.

Lista e projekteve të perealizuara përfshin:

- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve për rrjetin fekal (5);
- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve të rrjetit atmosferik (7);
- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve për karregjatë (10);
- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve për trotuare, shtigje për këmbësorë dhe biçikleta, barriera arkitekturore (15);
- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve për planet për infrastrukturën e komunikacionit, projekte për komunikacion rrugor, projekte për mënyrën e komunikacionit rrugor dhe projekte për sinjalizim (12);
- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve për ndërtimin e platformave për hyrje për personat me pengesa (1);
- ▶ Projekte dhe revidim të projekteve për zonat për kanakar (1);
- ▶ Rindërtimi i rrjetit të ujësjellësit (2);
- ▶ Rikonstruksioni i rrjetit fekal (5);
- ▶ Rindërtimi i rrjetit atmosferik (6);
- ▶ Rindërtimi i karregjatës (17);
- ▶ Rindërtimi i trotuareve, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta, mureve arkitekturore dhe mbajtëse (12).

Përndryshe, Komuna Qendër në vitin 2022 ka shpenzuar 96.492.265 denarë [1,6 milion euro] për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, që është 93% më tepër se 49.996.004 denarë [812.940 euro], shumë e cila është shpenzuar një vit më parë.

12. Çair

Me shumën prej 59.768.321 denarë [971.843 euro], e radhës në listën e NjVL-ve të cilat kanë dështuar më së shumti në realizimin e objekteve ndërtimore të infrastrukturës është komuna e Çairit.

Sipas përgjigjeve që i fituam nga komuna, të [pa] realizuara tërësisht janë 4 projektet e mëposhtme:

- ▶ Efikasiteti energjetik në shkollat fillore, kopshtet për fërmijë dhe objektin e Komunës së Çairit; Mjete të parapara 4.500.000 denarë, të realizuara 500.000, të perealizuara 4.000.000 denarë.
- ▶ Infrastrukturë nëntokësore; janë paraparë 24.000.000 denarë, janë realizuar 16.000.000 denarë, 8.000.000 denarë të perealizuara që janë bartë në buxhetin për vitin 2023.
- ▶ Rrjeti i ujësjellësit; janë paraparë 20.000.000 denarë, janë realizuar 16.000.000 denarë, 4.000.000 denarë të perealizuara që janë transferuar në buxhetin për vitin 2023.
- ▶ Salla sportive "Shaban Tërstena" - ndërrim i parketit. Janë planifikuar 1.500.000 denarë, janë realizuar 900.000 denarë, 600.000 denarë të perealizuara të cilat janë transferuar në buxhetin e vitit 2023.

Në të njëjtën kohë, kjo komunë ka shpenzuar 95.097.501 denarë [1,5 milion euro] për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport në vitin 2022, që është pothuaj dyfish, përkatësisht 95,8% më tepër në bazë vjetore.

13. Aerodrom

Sipas përgjigjeve nga komuna Aerodrom, nuk janë ndërtuar këto objekte që janë paraparë për vitin 2022:

- ▶ Rruga e hyrjes nr. 7 l11 i katërt bl. 11, vendbanimi Miçurin;
- ▶ Rruga e hyrjes nr. 2 l11 i katërt bl. 9, vendbanimi Miçurin;
- ▶ Rruga 2, e re e planifikuar me parkim në lagjen l11, bl. 12, vendbanimi Miçurin;
- ▶ Rruga 7, e re e planifikuar me parkim në l11 të katërt, bl. 12, vendbanimi Miçurin;
- ▶ Parking 5.17 në PDU, Kisha UEB blloku 5;
- ▶ Pjesë e parkingut 1.10 në Kisha UEB blloku 1;
- ▶ Parking 2.13 në PDU, Kisha UEB blloku 2;

- ▶ Kapaciteti i furnizimit me ujë në rrugën e planifikuar të re 6 në PDU, Kisha UEB blloku 5;
- ▶ Kanalizim atmosferik në rrugën rezidenciale 2 te sapoplanifikuar me parkim ne l11 të katërt, bl. 12, lagjen Miçurin;
- ▶ Kanalizim atmosferik në rrugën hyrëse nr. 2 l12 i katërt, bl. 9, vendbanimi Miçurin;
- ▶ Kanalizim atmosferik në një pjesë të parkingut 1.10 në Kisha UEB blloku 1;
- ▶ Parking 2.13 në DUP Kisha UEB blloku 2;
- ▶ Ndriçim publik i parkingut 5.17 me rrugë servis 6 në PDU Kisha UEB blloku 5;
- ▶ Ndriçimi publik i një pjese të rrugës së sapoplanifikuar 5 në PDU Kisha UEB blloku 4;
- ▶ Ndriçimi publik i Parkimit 2.13 në PDU Kisha UEB blloku 2.

Përndryshe, sipas të dhënave nga Propozim- llogaria përfundimtare, Komuna e Aerodromit nuk ka realizuar investime nga zëri buxhetor 482 – Objektet tjera ndërtimore, në vlerë prej 52.941.284 denarë, (860.834 euro).

Nga zëri buxhetor 421 – Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, vitin e kaluar, kjo komunë ka shpenzuar 129.515.692 denarë (2,1 milionë euro), që është 88,3% më tepër se në vitin 2021.

14. Radovish

Në vitin 2022, Komuna e Radovishit nuk ka realizuar objekte të infrastrukturës ndërtimore në vlerë prej 42.451.857 denarë (690.274 euro).

Lista e projekteve kapitale të përealizuara përfshin:

- ▶ Ndërtimi i rrugëve (2);
- ▶ Ndërtimi i kanalizimit fekal (4);
- ▶ Rikonstruksion, mbindërtim në asfaltin ekzistues;
- ▶ Rregullimi i hapësirave publike, trotuareve, shtigjeve, parkingjeve (2);
- ▶ Përgatitja e dokumentacionit të plotë teknik për ndërtim;

- ▶ Ndërtimi i objektit ndihmës në Shtëpinë e Kulturës “Aco Karamanov”;
- ▶ Ndërtimi i rrugës lokale-qarkore;
- ▶ Rruga lokale Bell Kamen – Autokamp;
- ▶ Ndërtimi i rrugëve urbane (3);
- ▶ Ndërtimi i zonës qendrore urbane;
- ▶ Ndërtimi i urës në lumin Marlanda;
- ▶ Rehabilitim i objektit të EVN-së;
- ▶ Sanim derdhjes së dheut në rrugën Podarësh;
- ▶ Ndërtimi i rrugës lokale (2);
- ▶ Ndërtimi i murit mbajtës;
- ▶ Sanim i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.

Përmes zërit 421, në vitin 2022, Komuna e Radovishit ka shpenzuar 43.394.388 denarë (705 mijë euro), që është 30% më tepër se në vitin 2021.

15. Negotinë

Në vitin 2022 kur ishte krizë, komuna e Negotinës nuk ka realizuar gjithsej 39.618.377 denarë (644.201 euro) nga shumata e mjeteve të buxhetuara në zërin 482 - Objekte tjera ndërtimore.

Projektet e mëposhtme kanë mbetur të përealizuara:

Programi JN, janë planifikuar 400.000 denarë:

- ▶ Rregullimi i zonës-park në afërsi të rr. “Vëllezërit Milladin”;
- ▶ Blerja e kontejnerëve 11 metër kub;
- ▶ Rindërtimi i këndeve për lojëra për fëmijët në vendbanimet Krivollak, Temjanik, Dollni Disan, Kurija, Vojshanci dhe Cërveni Bregovi.

Programi KA, janë planifikuar 50.000 denarë

- ▶ Rindërtimi i monumenteve.

Programi EA, janë planifikuar 50.000 denarë:

- ▶ Rikonstruksioni i objekteve të tjera (dyer, dritare, etj.).

Për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, kjo komunë në vitin 2022 ka shpenzuar 39.220.455 denarë (637.730 euro), që është 70% më tepër se në vitin 2021.

16. Çuçer Sandevë

Komuna Çuçer Sandevë në vitin 2022 nuk ka realizuar 37.720.797 denarë (613.346 euro) nga mjetet e parapara për investime në objekte infrastrukturore.

Por, në përgjigjen që na e kanë dërguar, komuna ka përmendur vetëm një projekt të parealizuar për këtë shumë:

- ▶ Rindërtimi i rrugëve në fshatin Pobožhje.

Zëri buxhetor për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport në vitin 2022 arrin shumën prej 14.898.025 denarë (242.244 euro), që është 45% më tepër se vitin e mëparshëm.

17. Tetovë

Komuna e Tetovës ka dorëzuar listën e projekteve të planifikuara në zërin buxhetor 482, por që nuk janë realizuar gjatë vitit 2022.

Bëhet fjalë për projektet në vijim:

- ▶ Matjet laboratorike dhe materialet për ndërtimin e rrugëve;
- ▶ Ndërtimi i shtandeve sezonale për festat vjetore;
- ▶ Ndërtimi i ndriçimit publik në Blv. "Tosca";
- ▶ Ndërtimi i rrugës Kale - lidhja me rrugën Tetovë - Sellce, faza II;
- ▶ Rehabilitimi i rrugës "R. Konike";
- ▶ Rehabilitimi i rrugës "V. Miladinov";
- ▶ Ndërtimi i shtratit të lumit Shkumbin (ura në Blv. "V. S. Bato" deri në autostradën rajonale Shkup - Kërçovë);

- ▶ Rikonstrukcioni i ujësllësit për një pjesë të fshatit Poroj;
- ▶ Sistemi i furnizimit me ujë në fshatin Pinxhur.

Plani për prokurime publike i Komunës së Tetovës për vitin 2022, gjatë vitit ka përfshirë edhe disa projekte për të cilat nuk është publikuar shpallje dhe ato nuk janë realizuar, siç është mbushja e gropave, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve në qytetin e Tetovës dhe i rrjeteve rrugore në fshatrat malore për rrëshqitjet e tokës, ndërtimi i sinjalistikës vertikale (semaforë) në rrugëkryqet me zgjidhje bulevardi në qytetin e Tetovës, si dhe ndërtimi i ndërtesës administrative (inspektorati).

Kjo komunë nuk ka realizuar 37471.290 denarë (609.289 euro) nga investimet e planifikuara për Objekte tjera ndërtimore.

Për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, në vitin 2022, kjo komunë ka shpenzuar 97.670.144 denarë (1.588.132 euro), që paraqet rritje të shpenzimeve për 53,7% në bazë vjetore.

18. Koçani

Komuna e Koçanit, gjatë vitit 2022 nuk ka realizuar gjithsej 36.087.630 denarë (586.791 euro) të planifikuara në zërin buxhetor 482.

Sipas përgjigjeve nga komuna, për këtë shumë, nuk janë realizuar projektet në vijim:

- ▶ Përpunim i dokumentacionit të projektit për Urë;
- ▶ Ndërtimi i objekteve të banimit për personat në rrezik social;
- ▶ Asfaltimi dhe rehabilitimi i rrugës "Braça Stavrevi";
- ▶ Rehabilitimi i rr. "Goce Dellçev";
- ▶ Rehabilitimi i rr. "Maqedoni".

Ndërkaq, në vitin e njëjtë, shpenzimet nga zëri buxhetor 421, i cili kryesisht është në lidhje me energji, janë zmadhuar dyfish (99,7%), në 58.905.683 denarë (957.815 euro).

19. Butel

E fundit në listë, me mjete të parealizuara nga zëri buxhetor 482, pak mbi mesataren për të gjitha komunat në vitin 2022 me një shumë prej 35458.760 denarë (576.565 euro), është komuna e Butelit.

Kjo është lista e projekteve të parealizuara të cilat kjo komunë i ka planifikuar në zërin buxhetor 482, sipas kategorive dhe numrit të objekteve të parealizuara:

- ▶ Ndërtimi, rikonstruktimi dhe rehabilitimi i rrugëve lokale dhe rrugëve urbane; Përgatitje e projekteve, projektim i rrugëve urbane dhe rrugëve lokale; Të parealizuara: 51
- ▶ Rikonstruktimi i rrugëve lokale dhe rrugëve urbane; Të parealizuara: 33
- ▶ Ndërtimi i rrugëve urbane dhe rrugëve lokale; Të parealizuara: 3
- ▶ Ndërtimi, rikonstruktimi dhe rehabilitimi i objekteve tjera; Të parealizuara: 19
- ▶ Ndërtimi i sistemeve të kullimit dhe pastrimit të ujërave të zeza; Përgatitje e projekteve, projektimi i rrugëve urbane dhe rrugëve lokale; Të parealizuara: 27
- ▶ Ndërtimi i objekteve tjera; Të parealizuara: 34

Megjithatë, në vitin 2022, shuma e shpenzuar nga zëri buxhetor 421 është 60.735.764 denarë (987.573 euro) dhe paraqet 61,6% më tepër se në vitin 2021.

Transferet nga niveli qendror në nivel lokal janë në rritje

Transferet të cilat pushtetet lokale i fitojnë nga buxheti qendror janë zmadhuar edhe në vitin 2022, së pari me rebalansin, e më pas me rishpërndarjen e mjeteve nga shuma 22.321.349.000 denarë (363 milionë euro) e cila ka qenë fillimisht e përcaktuar, në 23.442.534.000 denarë (381,2 milionë euro).

Gjatë kësaj, realizimi është thujse i plotë, kështu që, sipas të dhënave nga Llogaria Përfundimtare, në vitin 2022 janë realizuar dotacione në shumë të përgjithshme prej 23.364.851.480 denarë (380 milionë euro), që paraqet 12% të totalit të shpenzimeve të Buxhetit Themelor. Në krahasim me vitin 2021, ato janë zmadhuar për 10%.

Pjesa më e madhe e shumës është transferuar në formë të bllok dotacioneve, përkatësisht shumë prej 20.041.118.437 denarë (325,9 milionë euro), 2.910.000.000 denarë (47,3 milionë euro) janë dotacione nga TVSH-ja, ndërsa 413.733.043 denarë (6,7 milionë euro) janë dotacione me dedikim.

Dotacionet janë transferim i mjeteve nga Buxheti dhe nga fondet në buxhetet e komunave, e me të cilat sigurohen të ardhura shtesë për financimin e kompetencave të komunave në përputhje me decentralizimin fiskal të NjVL-ve, që ka filluar në vitin 2005.

Në nenin 8 të Ligjit për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale janë përcaktuar llojet e granteve, edhe atë: të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, dotacion me dedikim, dotacion kapital, bllok dotacion dhe dotacion për kompetencë të deleguar.

- ▶ **Bllok dotacionet** janë të dedikuara për financimin e kompetencave të komunave në fushën e kulturës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, arsimit. Pjesa më e madhe e shumës është dedikuar për arsimin fillor, pastaj për arsimin e mesëm dhe më së paku për mbrojtjen sociale të fëmijëve. Gjatë kësaj, realizimi i bllok-dotacioneve në vitin 2022 është rritur për 920,685 milionë denarë

(15 milionë euro) më tepër se mjetet e planifikuara me rebalansin e fundit të Buxhetit për vitin 2022, për shkak të rritjes së pagave të të punësuarve në kopshtet për fëmijë dhe të punësuarve në shkollat fillore dhe të mesme për 15%, duke filluar nga muaji shtator i vitit 2022.

- ▶ **Transferet nga të ardhurat prej TVSH-së** për NjVL-të, sigurohen në lartësi prej 5% të totalit të inkasuar të TVSH-së, të realizuar në vitin e kaluar fiskal. Këto mjete transferohen nga Ndarja e Ministrisë së Financave – Funksione të shtetit, nënprogrami - Decentralizim, drejtpërsëdrejti në llogaritë e komunave, ndërsa komuna vendos në mënyrë të pavarur për shfrytëzimin e parave. Gjatë vitit 2022, paratë e transferuara në këtë bazë janë zmadhuar për 30% krahasuar me vitin 2021, për shkak të inkasimit të zmadhuar të TVSH-së, por edhe për shkak të rritjes së pjesëmarrjes së transfereve nga 4.5% në 5%.
- ▶ **Dotacioni me dedikim** përdoret për financimin e ndonjë aktiviteti specifik të komunës, me dedikim rreptësisht për ndonjë projekt dhe institucion apo program me përlllogaritjen buxhetore për vitin e ardhshëm. Gjatë vitit 2022, janë shpërndarë dotacione me dedikim në bazë të: Financimit të kompetencave të transferuara në arsimin fillor të cilat u dedikohen komunave në vlerë prej 3.200.000 denarë, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Dotacione për paga dhe shtojca në paga për të punësuarit në njësitë territoriale të zjarrfikësve në vlerë totale prej 410.533.000 denarë, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes.

Në komuna konkrete, më së shumti mjete nga buxheti qendror, në formë të transfereve fitojnë komunat më të mëdha, përkatësisht Qyteti i Shkupit, komuna e Kumanovës, komuna e Tetovës, komuna e Manastirit dhe komuna e Prilepit.

NjVL-të me transferet më të mëdha nga pushteti qendror në vitin 2022

NjVL	Shuma në denarë
Qyteti i Shkupit	2,514,721,444
Kumanovë	1,278,235,502
Manastir	1,190,212,098
Tetovë	1,187,650,066
Prilep	920,513,388
Gostivar	852,358,712
Strumicë	725,027,980
Strugë	711,687,302
Aerodrom	675,192,112
Veles	641,783,669

Nga ana tjetër, analiza e të dhënave për transferet nga pushteti qendror në komunat për kokë banori, sugjeron në një mospërputhje të madhe ndërmjet disa komunave.

Kështu, për shembull, transferet dallojnë nga shuma minimale prej 3.494 denarë për kokë banori në Qytetin e Shkupit, deri në shumën maksimale 20.097 denarë për kokë banori në komunën Mavrovë dhe Rostushë.

NjVL-të me transferet më të mëdha dhe më të vogla nga pushteti qendror në vitin 2022, për kokë banori

NjVL	Shuma në denarë
Mavrovë dhe Rostushë	20,097
Qendra Zhupë	19,393
Karbinci	15,158
Berovë	14,706
Maqedonska Kamenica	14,385

NJVL	Shuma në denarë
Qyteti i Shkupit	3,494
Gorçe Petrov	5,394
Aerodrom	5,786
Kisella Voda	6,280
Studenica	6,880

Është e qartë që pjesa më e madhe e transfereve nga pushteti qendror për NJVL-të janë për paga dhe kjo në mënyrë plotësuese e përkeqëson strukturën e shpenzimeve të buxheteve lokale.

Sipas të dhënave për realizimin e buxheteve në nivel lokal për vitin 2022, të gjitha komunat së bashku kanë shpenzuar gjithsej 39.697.534.979 denarë (645,5 milionë euro), nga të cilat 19.899.984.393 denarë (323,6 milionë euro) kanë qenë të dedikuara për pagesë të pagave dhe kompensimeve që paraqet, për shembull tri herë më tepër se shuma për shpenzime kapitale, dedikim për të cilin janë shpenzuar vetëm 105,4 milionë euro.

Përndryshe, transferet për NJVL-të shënojnë një tendencë të rritjes së vazhdueshme gjatë viteve. Vetëm gjatë pesë viteve të fundit ato janë zmadhuar nga 254,1 milionë euro në vitin 2018, në 380 milionë euro këtë vit, që paraqet një rritje prej 51%.

Me ndryshime ligjore për të ardhura më të mëdha për komunat

Rritja e transfereve nga niveli qendror në nivel lokal është në përputhje me aplikimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, i cili filloi të zbatohet nga viti 2022.

Me zgjidhjet e reja ligjore, ideja e autoriteteve ishte që komunat të fitojnë më shumë të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe TVSH-ja.

Me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve fiskale të komunave, në këtë ligj ishte paraparë një rritje graduale e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale nga

3% në 4% në vitin 2022, më pas në 5% në 2023 dhe në fund, në 6% deri në vitin 2024. Këto të ardhura, komunat i marrin nga të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale nga pagat e personave fizik të arkëtuara në komunën në të cilën janë të regjistruar me vendbanim të përhershëm apo vendqëndrim.

Gjithashtu, në drejtim të përmirësimit të kapacitetit fiskal dhe rritjes së të ardhurave komunale, ligji parasheh rritje graduale të shkallës së dotacionit nga TVSH-ja prej 4,5% në 5% në vitin 2022, në 5,5% në vitin 2023 dhe deri në 6% në vitin 2024.

Në vitin 2022, komunave u janë ndarë edhe 5% të planifikuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar, të ndara në tri pjesë, përkatësisht: pjesa bazë - 4,5%, pjesa për performanse - 0,25 % dhe një pjesë për kompensim - 0,25%, me çka u janë paguar 291 milion denarë shtesë.

Reforma me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, siç sqaruan autoritetet në atë kohë, përbëhet nga tre shtylla: rritje e kapacitetit fiskal të komunave dhe rritje e të ardhurave, rritje e disiplinës financiare të komunave, zvogëlim i borxheve dhe punë me nikoqirllëk, si dhe transparencë dhe llogaridhënie më e madhe. Pritshmëritë ishin që masat dhe aktivitetet të sigurojnë demokratizim shtesë të shoqërisë, realizim më efikas dhe më ekonomik të shërbimeve, si dhe zhvillim të intensifikuar lokal e rajonal.

Mirëpo, pavarësisht tentativave ligjore për të zmadhuar të ardhurat e buxheteve lokale, një pjesë e madhe e komunave po ballafaqohen me probleme financiare.

Ndonëse transferet nga buxheti qendror, të mundësuar nga ndryshimet ligjore për një decentralizim më të madh fiskal, janë zmadhuar për 10% në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, megjithatë, të ardhurat e përgjithshme të të gjitha NJVL-ve në nivel vjetor janë zmadhuar pak, vetëm për 0,9 %, kryesisht për shkak të inkasimit më të dobët të Tatimeve për shërbime specifike. Enti Shtetëror i Revizionit konstaton që në disa komuna ka nivel të ulët të grumbullimit të të ardhurave komunale për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të personelit.

Për probleme financiare në nivel vendor sugjeron fakti që shumica e përgjithshme e detyrimeve të maturuara që janë raportuar është ende e lartë, pavarësisht tentativave të shtetit në vitin 2018 për t'i zvogëluar ato në minimum, duke siguruar para nga buxheti qendror për shlyerjen e borxheve të akumuluar. Kështu, nga viti 2018, pas veprimit të Qeverisë, detyrimet e maturuara të komunave janë zvogëluar prej në 4.998.269.598 denarë (81,3 milionë euro) në 3.044.124.921 denarë (49,5 milionë euro) në vitin 2019. Deri në fund të vitit 2022, detyrimet e maturuara të NjVL-ve janë rritur sërish dhe kanë arritur shumën prej 4.084.138.029 denarë (66,4 milionë euro).

Gjithashtu, Enti Shtetëror i Revizionit ka konstatuar që në dhjetor 2022, nga gjithsej 81 komunë, 14 komuna janë me llogari të bllokuar.

Përndryshe, në nenin 39 të Ligjit për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale është përcaktuar që nëse llogaria e komunës është e bllokuar më gjatë se gjashtë muaj ose shumica totale e detyrimeve të papaguara për më shumë se 60 ditë është më tepër se 80% e të ardhurave të realizuara të buxhetit themelor të komunës në vitin paraprak, kryetari i komunës është i detyruar të sjell vendim për shpallje të paqëndrueshmërisë financiare.

Me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale nga muaji gusht i vitit 2022, me nenin 39 ndryshohet edhe përqindja e detyrimeve të papaguara, përkatësisht paqëndrueshmëri financiare e komunës shpallet nëse shumica totale e detyrimeve të papaguara mbi 60 ditë, tejkalon 60% të të ardhurave të realizuara të buxhetit bazë të komunës në vitin paraprak, dispozitë e cila do të fillojë të zbatohet nga 1.1.2024.

Deri në periudhën e revizionit të kryer nga ana e ESHR-së, nuk ka ndodhur të shpallet paqëndrueshmëri financiare në asnjë komunë dhe sipas revizorëve, "kjo situatë u mundëson komunave të gjenerojnë detyrime të reja mbi baza të ndryshme, të fillojnë projekte të reja kapitale, të cilat mund të ndikojnë në përkeqësimin e likuiditetit të tyre dhe gjendjen e përgjithshme financiare në të

ardhmen, e me këtë edhe mundësi për nevojë shtesë për ndarje të mjeteve nga Buxheti si mbështetje financiare për ato, që nënkupton ngarkesë shtesë për Buxhetin".

Mungesa e mjeteve financiare për komunat për realizimin e kompetencave të tyre dhe varësia e tyre prej transfereve nga pushteti qendror shpie edhe deri në zhvillim të pamjaftueshëm dhe të pabarabartë rajonal, sigurim dhe realizim joefikas të shërbimeve për qytetarët dhe demokratizim të pamjaftueshëm të shoqërisë në përgjithësi.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë për zhvillim të barabartë ekonomik, rajoni i Shkupit vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe në krijimin e bruto prodhimit vendas (BPV) prej pothuaj 44%, ndërsa rajonet e tjera dukshëm më pak dhe kjo strukturë nuk ndryshon.

Enti Shtetëror i Revizionit konstaton që krahas asaj që fondet për stimulimin e zhvillimit të barabartë rajonal, të cilat, në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Zhvillimin e Barabartë Rajonal, duhet të jenë së paku 1% e BPV-së, tejkalojnë edhe 1.5% të BPV-së, megjithatë "tek programet e përmendura të cilat kanë një komponent të zhvillimit rajonal, nuk është gjithmonë e mundur të verifikohet tërësisht përmbushje e "parimit të barazisë", përkatësisht shpërndarje e mjeteve financiare në të gjitha rajonet e planit konform shkallës së zhvillimit të tyre, apo se ato kontribuojnë në stimulimin e zhvillimit të barabartë rajonal."

Përndryshe, decentralizimi fiskal është një nga prioritetet që burojnë nga Partneriteti për anëtarësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian. Decentralizimi i mëtejshëm ishte një nga prioritetet e përcaktuara me Programin e Qeverisë 2021-2024.

Përfitimet nga decentralizimi, si proces në përgjithësi, janë demokratizimi shtesë, transferimi i kompetencave të autoriteteve më afër qytetarëve dhe nevojave të tyre dhe në këtë mënyrë, dhënie të shërbimeve më efikase dhe më ekonomike për qytetarët. Disa studime akademike sugjerojnë që ekziston një korrelacion midis një shkalle më të lartë të decentralizimit me shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik.

REKOMANDIME

- ▶ Komunat duhet të bëjnë përpjekje shtesë për realizimin sa më të plotë të buxheteve të planifikuara. Në veçanti, duhet bërë përpjekje për zmadhimin e shpenzimeve kapitale, të cilat kanë një nivel shqetësues të ulët të pjesëmarrjes në buxhetet e komunave individuale, për dallim nga madhësia dhe rritja e vazhdueshme e shpenzimeve rrjedhëse-operative.
- ▶ Të ngritet informimi i publikut për detyrimet e komunave, si për detyrimet e maturuara të papaguara ashtu edhe për detyrimet që nuk janë maturuar dhe duhet të paguhen në vitin rrjedhës fiskal ose në vitet e ardhshme fiskale. Në këtë mënyrë duhet të ndikohet në prioritizim të shpenzimeve nga ana e komunave dhe të nevojës për racionalitet dhe ekonomizim më të madh në shpenzimet.
- ▶ Pagesa e detyrimeve të prapambetura nga buxhetet rrjedhëse dhe transferimi i pagesave për projektet aktuale për vitin e ardhshëm e pengojnë saktësinë maksimale të verifikimit të vlerës së projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara e që nuk janë realizuar. Ky është një problem i perceptuar kryesisht te shumica e komunave. Kjo e shton nevojën për përgjegjësi më të madhe ndaj qytetarëve në nivel projektesh dhe aktiviteteve, e jo të zërave buxhetorë.
- ▶ Të vendoset detyrimi për informim të qytetarëve në nivel vjetor lidhur me të gjitha projektet e planifikuara e të përealizuara si dhe për shkurtime në buxhet që drejtpërdrejt janë në lidhje me dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve.
- ▶ Në të ardhmen duhet të parashikohen mekanizma dhe mënyra, që shkurtime buxhetore për rrethana të jashtëzakonshme të mos kompensohen me kredi të reja dhe me "marrje" parash nga ato projekte dhe fonde nga të cilat varet drejtpërdrejt jeta e njerëzve, por nga ato "zëra" buxhetorë që nuk kanë ndikim të tillë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi qytetarët dhe jetën e tyre.
- ▶ Komunat duhet të zmadhojnë transparencën dhe llogaridhënien në drejtim të dhënies së të dhënave më të hollësishme dhe të kuptueshme lidhur me shpenzimet buxhetore. Ky rekomandim buron nga përpjekjet e jashtëzakonshme që duhej të bëhen për t'i fituar të dhënat për projektet kapitale komunale të përealizuara, të nevojshme për analizën.
- ▶ Është e nevojshme që gradualisht të kalohet në aplikim të plotë të sistemit për kontabilitet për llogaritës, në vend të raportimit aktual në bazën e parave të gatshme. Njoftimet e pjesshme për detyrimet sipas skadencës, pra për kërkesat, të zëvendësohen me një sistem të plotë kontabiliteti në bazë të për llogaritjes. Për atë qëllim të përkthehen dhe publikohen të gjitha Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për sektorin publik dhe të bëhen ndryshimet e duhura ligjore si dhe të miratohen aktet nënligjore. Procesi duhet të zbatohet gradualisht, me trajnimin e personelit profesional, i cili punon në kontabilitetin e sektorit publik/buxhetor.
- ▶ Të publikohet evidenca analitike me llogaritë analitike gjashtëshifrore e buxheteve dhe e të gjitha dokumenteve përkatëse, në format të përshtatshëm për analizë. Njëkohësisht, secilit raport tremujor t'i bashkëngjiten shënime me arsyetimin e zërave buxhetorë ndaras, në të cilat shpenzimet, para së gjithash, do të evidentohen në llogari nën analitike, duke përmendur arsyet për dallimet e paraqitura.

- ▶ Të zbatohet kodifikimi i evidencës për të shmangur evidentimin e llojit të njëjtë të shpenzimeve, të ardhurave, mjeteve dhe detyrimeve të shfrytëzues të ndryshëm buxhetorë dhe shfrytëzues individualë.
- ▶ Të gjitha të dhënat që janë në lidhje me shpenzimet buxhetore, siç janë buxhetet, llogaritë përfundimtare, raportet, etj., duhet të publikohen në format të hapur për të mundësuar përdorimin, përpunimin dhe analizimin e tyre plotësisht.
- ▶ Të sigurohet një sistem elektronik për arkëtimin e tatimit mbi pronë sipas llojit të pronës së regjistruar të obliguesve tatimor të institucionet kompetente shtetërore në përputhje me shfrytëzimin funksional të pronës, për banim, dhënie me qira, pronë jofunksionale, pronë me dedikim ekonomik, pronë që përdoret në bujqësi etj. Sipas ndarjes së këtillë do të mundësohet zbatim adekuat i dispozitave të Ligjit për Tatimin mbi Pronë, sipas të cilit, tatimi mbi pronë paguhet konform dedikimit funksional të pronës.

SHTOJCA

Buxhetet e realizuara të NjVL-ve në vitin 2022

Komuna	Në denarë	Në euro
Qyteti i Shkupit	5,783,131,666	94,034,661
Kumanovë	1,859,090,286	30,229,110
Manastir	1,858,319,097	30,216,571
Tetovë	1,526,335,202	24,818,459
Prilep	1,288,587,417	20,952,641
Strumicë	1,217,311,189	19,793,678
Ohër	1,166,993,316	18,975,501
Aerodrom	1,119,348,591	18,200,790
Gostivar	1,116,532,528	18,155,000
Karposh	1,089,144,702	17,709,670
Gazi Baba	1,086,459,245	17,666,004
Kavadari	1,082,255,383	17,597,649
Strugë	1,039,969,814	16,910,078
Shtip	948,169,518	15,417,391
Qendër	928,661,155	15,100,181
Veles	911,854,864	14,826,908
Çair	838,511,179	13,634,328
Kërçovë	804,790,174	13,086,019
Kisella Voda	740,464,434	12,040,072
Koçani	593,098,166	9,643,873
Gorçe Petrov	509,932,326	8,291,583
Butel	493,633,814	8,026,566
Radovish	476,356,697	7,745,637
Gjevgjeli	461,413,178	7,502,653
Saraj	406,799,167	6,614,621
Kriva Pallankë	400,267,291	6,508,411
Shën Nikole	391,382,826	6,363,948
Likovë	377,674,945	6,141,056
Negotinë	373,022,919	6,065,413
Ilinden	328,284,998	5,337,967
Dibër	325,888,080	5,298,993
Probishtip	321,091,358	5,220,998
Vrapçishtë	306,280,055	4,980,163
Resnjë	296,405,104	4,819,595
Berovë	288,200,108	4,686,181
Vinicë	287,021,184	4,667,011
Petrovec	285,612,570	4,644,107
Dellçevë	277,832,988	4,517,610
Bogovinjë	272,793,719	4,435,670
Zhelinë	264,605,371	4,302,526

Komuna	Në denarë	Në euro
Shuto Orizarë	254,676,781	4,141,086
Dollneni	243,378,766	3,957,378
M. Kamenica	240,530,897	3,911,071
Bërvenicë	233,476,357	3,796,364
Studenica	225,959,279	3,674,135
Vallandovë	219,820,195	3,574,312
Tearcë	219,029,076	3,561,448
Mavrovë dhe Rostushë	170,803,880	2,777,299
Maqedonski Brod	170,742,813	2,776,306
Bogdanci	166,282,535	2,703,781
Kratovë	163,572,275	2,659,712
Krushevë	162,024,402	2,634,543
Novo Sellë	160,577,489	2,611,016
Demir Hisar	151,912,344	2,470,119
Çashkë	151,516,454	2,463,682
Jegunovcë	148,827,589	2,419,961
Vasilevë	144,580,328	2,350,900
Çuçer - Sandevë	143,834,329	2,338,770
Bosilovë	139,643,248	2,270,622
Sopishtë	137,790,657	2,240,498
Karbinci	135,183,448	2,198,105
Demir Kapi	126,617,792	2,058,826
Haraçinë	124,106,318	2,017,989
Novaci	119,904,612	1,949,668
Qendra Zhupë	107,573,146	1,749,157
Mogillë	105,114,715	1,709,182
Dojran	103,825,119	1,688,213
Debërca	100,014,047	1,626,245
Rosoman	99,513,938	1,618,113
Çeshinovë - Obleshevë	98,850,733	1,607,329
Nagoriçani i Vjetër	98,585,750	1,603,020
Konçe	97,969,793	1,593,005
Pehçevë	91,132,719	1,481,833
Krivogashtani	87,574,538	1,423,976
Gradsko	78,812,020	1,281,496
Rankovce	78,496,190	1,276,361
Zelenikovë	67,705,314	1,100,899
Llozovë	60,822,011	988,976
Vevçani	47,496,532	772,301
Zërnovci	45,454,799	739,102
Pllasnicë	30,275,127	492,278

Buxhetet e realizuara në vitin 2022, për kokë banori

Komuna	Në denarë	Në euro
Novaci	45,281	736
Karbinci	39,527	643
Makedonska Kamenica	37,355	607
Konçe	35,952	585
Mavrovë dhe Rostushë	33,876	551
Dojrani	33,666	547
Demir Kapi	33,523	545
Petrovec	31,214	508
Kavadari	30,287	492
Makedonski Brod	28,994	471
Qendra Zhupë	28,918	470
Nagoriçani i Vjetër	28,159	458
Debërca	26,893	437
Llozovë	26,865	437
Berovë	26,465	430
Rosoman	26,215	426
Shën Nikole	25,547	415
Gradsko	24,377	396
Strumicë	24,349	396
Probishtip	23,932	389
Novo Sellë	23,032	375
Pehçevë	22,880	372
Ohër	22,692	369
Bogdanci	22,657	368
Rankovcë	22,654	368
Kriva Pallankë	22,164	360
Manastir	21,820	355
Zërnovci	21,790	354
Kratovë	21,680	353
Gjevgjeli	21,380	348
Qendër	21,157	344
Dibër	21,145	344
Shtip	21,133	344
Demir Hisar	20,925	340
Vallandovë	20,919	340
Resnjë	20,622	335
Sopishtë	20,526	334
Negotinë	20,503	333
Dellçevë	20,451	333
Strugë	20,400	332

Komuna	Në denarë	Në euro
Kërçovë	20,288	330
Zelenikovë	20,144	328
Vevçani	20,134	327
Mogillë	19,897	324
Vinicë	19,829	322
Radovish	19,748	321
Krushevë	19,323	314
Çashkë	19,078	310
Kumanovë	18,950	308
Ilinden	18,829	306
Veles	18,815	306
Koçani	18,768	305
Gostivar	18,680	304
Prilep	18,668	304
Dollneni	18,542	301
Çeshinovë – Oblesëvë	18,068	294
Tetovë	18,006	293
Bërvenicë	17,111	278
Karposh	17,082	278
Krivogashtani	16,949	276
Likovë	16,930	275
Jegunovcë	16,732	272
Çuçer – Sandevë	15,634	254
Gazi Baba	15,604	254
Vrapçisht	15,436	251
Aerodrom	14,400	234
Zhelinë	13,935	227
Vasilevë	13,702	223
Çair	13,398	218
Butel	13,001	211
Tearcë	12,379	201
Bosillovë	12,134	197
Kisella Voda	11,950	194
Bogovinjë	11,909	194
Gorçe Petrov	11,371	185
Qyteti i Shkupit	10,984	179
Saraj	10,594	172
Studenica	10,285	167
Shuto Orizarë	9,900	161
Haraçinë	9,791	159
Pllasnicë	7,171	117

MATERIALET DHE BURIMET E TË DHËNAVE QË JANË PËRDORUR

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 287/2021

Sistemi elektronik për Prokurime Ppublike

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2018

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas subjekteve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas grupeve të subjekteve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojeve të komitentëve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas subjekteve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas grupeve të subjekteve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojeve të komitentëve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas subjekteve për periudhën dhjetor 2020

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas grupeve të subjekteve për periudhën dhjetor 2020

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve për periudhën dhjetor 2020

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojeve të komitentëve për periudhën dhjetor 2020

Realizimi i buxheteve të NjVL-ve për periudhën 11.-31.12.2022

Realizimi i buxheteve të NjVL-ve për periudhën 11.-31.12.2021

Ndryshime dhe plotësime të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 164/2022

Vendim për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 232/2022

Vendim për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 272/2022

Financa të hapura

Rregullore për klasifikimin e të ardhurave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 76/2009

Rregullore për klasifikimin e shpenzimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 76/2009

Propozim-Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar 2022

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar-dhjetor 2022

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar 2021

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar – dhjetor 2021

